



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 166

**Tiranë – E mërkurë, 16 shtator 2020**

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 702, datë 9.9.2020	Për miratimin e procedurës dhe të kriterëve për emërimin e administratorit të përkohshëm, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e përkohshëm të shoqërisë ndaj së cilës është vendosur detyrimi i shërbimit publik, të cilës i është hequr licenca.....	12005
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 703, datë 9.9.2020	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore me nomenklaturë k-34-112-127-d, me numër pasurie 402, 403, 404, 405, 406, 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMT), 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMT), 412, 413 e 414, zona kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, Njësia Administrative Libofshë, dhe të pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-111-(111-d), me numër pasurie 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, zona kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë.....	12009
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 9.9.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 231, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i segmentit rrugor ‘Pallati me shigjeta – rrethrotullimi ‘Shqiponja’”, të ndryshuar.....	12010
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 9.9.2020	Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, 2020–2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij.....	12013
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 9.9.2020	Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Albafilm” sh.a., Tiranë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Ministria e Kulturës.....	12033
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 9.9.2020	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njesisë Administrative Tiranë, të pasurisë 2/29, me vendndodhje në zonën kadastrale 8280.....	12033

Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 9.9.2020	Për një shtesë në udhëzimin nr. 3606/2 (18), datë 28.10.2011, “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D dhe DE, me certifikatën e aftësisë profesionale (CAP)”, të ndryshuar.....	12035
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 238, datë 11.9.2020	Për delegimin e kompetencave.....	12035
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 316, datë 14.9.2020	Për miratimin e rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.....	12035
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 10389, datë 14.9.2020	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	12050



**VENDIM**  
**Nr. 702, datë 9.9.2020**

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE  
TË KRITEREVE PËR EMËRIMIN E  
ADMINISTRATORIT TË  
PËRKOHSHËM, I CILI DO TË JETË  
PËRGJEGJËS PËR ADMINISTRIMIN E  
PËRKOHSHËM TË SHOQËRISË NDAJ  
SË CILËS ËSHTË VENDOSUR  
DETYRIMI I SHËRBIMIT PUBLIK, TË  
CILËS I ËSHTË HEQUR LICENCA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. KUSHTE TË PËRGJITHSHME**

1. Për qëllime të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) “Administrator i përkohshëm”, administratori që përkohësisht kryen detyrën e administrimit të shoqërisë së interesuar të gazit natyror, së cilës i është hequr licenca, dhe i cili është përgjegjës për të siguruar një aktivitet normal, përfshirë edhe operimin e asetëve të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca sipas kushteve përkatëse deri në marrjen e masave nga Këshilli i Ministrave, sipas pikës 8, të nenit 27, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

b) “Shoqëri e interesuar”, shoqëria që ushtron veprimtarinë e transmetimit, të shpërndarjes, të operimit të GNL-së ose të operimit të sistemit të depozitimit, ndaj së cilës është vendosur detyrimi i shërbimit publik dhe të cilës, në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 27, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, i është hequr licenca dhe është vendosur nën mbikëqyrjen e administratorit të përkohshëm.

2. Çdo term tjetër i përcaktuar në këtë vendim do të ketë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Kur një shoqëri e licencuar, të cilës i është vendosur detyrimi i shërbimit publik, është në kushtet e heqjes së licencës, ERE vendos masën e

emërimit të një administratori të përkohshëm të shoqërisë dhe përcakton detyrimet e kësaj shoqërie derisa licenca t’i rijepet shoqërisë së interesuar ose t’i jepet një personi tjetër juridik, por kjo periudhë nuk mund të zgjasë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e heqjes së licencës. Emërimi i një administratori të përkohshëm bëhet në mënyrë që pajiset dhe asetet në pronësi të shoqërisë së interesuar të mund të vazhdojnë të funksionojnë në sigurimin e shërbimit të gazit natyror për klientët. Procedura e emërimit të administratorit realizohet sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

4. Gjatë periudhës së administrimit, duke respektuar kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pezullohen të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e organeve drejtuese ekzistuese të shoqërisë së interesuar, si dhe të aksionarëve të saj, në funksion të përmbushjes së detyrimeve të licencës. Ky pezullim fillon nga data e marrjes së njoftimit për vendimin e Entit Rregullator të Energjisë lidhur me caktimin e administratorit të përkohshëm.

Të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese të shoqërisë, të cilat, në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, i takojnë këshillit mbikëqyrës (nëse është rasti) dhe/ose Asamblesë së Aksionarëve/Ortakëve, i kalojnë administratorit të përkohshëm.

**II. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË  
ADMINISTRATORIT TË PËRKOHSHËM**

1. ERE, në varësi të llojit të veprimtarisë që kryen shoqëria e interesuar, që i është vendosur detyrimi i shërbimit publik, së cilës do t’i hiqet licenca e ushtrimit të veprimtarisë, paralelisht me marrjen e vendimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës, harton në mënyrë të detajuar kërkesat që duhet të përmbushë kandidati për administrator të përkohshëm.

2. Gjithashtu, ERE merr masa që të identifikojë të gjitha detyrat dhe kompetencat që do të përmbushë administratori i përkohshëm gjatë periudhës që shoqëria e interesuar do të jetë në administrim të përkohshëm. Për të shmangur çdo dyshim, kompetencat dhe detyrat që ngarkohen të kryejë administratori i përkohshëm mund të jenë të ndryshme në varësi të shoqërisë së interesuar, si dhe llojit të veprimtarisë që ajo kryen.



3. Procedura e përzgjedhjes së administratorit të përkohshëm zhvillohet në dy faza:

a) Në fazën e parë, ERE përgatit një listë zgjedhjeje të kandidatëve aplikantë, të cilët përzgjidhen mbi bazën e aplikimit të bërë, pas përmbushjes së kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta;

b) Në fazën e dytë, kandidatët e përfshirë në listën e zgjedhjes i nënshtrohen intervistës me gojë, ku ndërmjet të tjerave, prezantojnë edhe platformat e tyre për sa i përket administrimit efektiv të shoqërisë së interesuar, së cilës i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për furnizim me gaz natyror.

4. Pasi ka hartuar kërkesat që duhet të përmbushë kandidati për administrator të përkohshëm, ERE përgatit një njoftim të detajuar, në bazë të të cilit fton kandidatët e interesuar për të marrë pjesë në procedurën për përzgjedhjen e administratorit të përkohshëm. ERE merr masa nëpërmjet publikimit të njoftimit për hapjen e procedurave për përzgjedhjen e një administratori të përkohshëm në faqen e saj të internetit, si dhe në dy gazetatat me qarkullim më të madh kombëtar, për 3 (tri) ditë me radhë. Shpallja e kërkesës përmban këto të dhëna:

a) një përshkrim të detyrave të administratorit të përkohshëm;

b) kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati;

c) kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati;

ç) një listë të dokumenteve që duhet të paraqiten, në bazë të të cilave provohet përmbushja e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta;

d) vendin ku do të paraqiten dhe afatën deri kur do të paraqiten dokumentet. Ky afat duhet të jetë jo më i vogël se 5 (pesë) ditë pune nga data e fundit e botimit të shpalljes për konkurrim. Në rast se brenda afatit të përcaktuar, për shkaqe objektive, një person i interesuar kërkon afat shtesë në dispozicion, ERE mund të shtyjë afatin e paraqitjes së aplikimit për jo më shumë se 3 (tri) ditë pune.

5. Detyrën e administratorit të përkohshëm mund ta ushtrojë personi fizik që plotëson, të paktën, kërkesat e përgjithshme të mëposhtme:

a) të ketë kryer studimet e larta të nivelit master shkencor ose profesional në profilet inxhinieri të sektorit të energjisë, ekonomik ose juridik;

b) të ketë eksperiencë pune si drejtues ekzekutiv ose drejtor i Përgjithshëm në sektorin publik apo privat, për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet. Do të konsiderohet i preferuar kandidati që eksperiencën e punës apo një pjesë të saj, si drejtues ekzekutiv ose drejtor i Përgjithshëm, e ka në sektorin e hidrokarbureve apo të energjisë elektrike;

c) të mos jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale që ka lidhje me profilin social dhe aktivitetin e kandidatit;

ç) kandidati aplikant të depozitojë një deklaratë, me shkrim, sipas kërkesave të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në të cilën deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se nuk ka asnjë lidhje varësie apo interesi me shoqërinë e interesuar, si dhe se ndaj tij nuk ka ndonjë pengesë në ushtrimin e kësaj detyre dhe as konflikt interesi në përputhje me ligjin.

6. Në përputhje me kërkesat dhe specifikat e shoqërisë së cilës i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për furnizim me gaz natyror, për të cilën janë hapur procedurat e heqjes së licencës dhe emërimit të administratorit të përkohshëm, ERE përcakton edhe kërkesat e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët aplikantë për administratorë të përkohshëm.

7. Me publikimin e njoftimit ku parashikohen kushtet dhe kërkesat për përzgjedhjen e administratorit të përkohshëm të shoqërisë së interesuar, ERE është e detyruar që të përgatisë një dosje elektronike të dhënash, ku të përfshijë të gjithë informacionin e detajuar mbi aktivitetin e shoqërisë së interesuar.

a) Të gjithë aplikantët e interesuar kanë të drejtë që:

i. gjatë përgatitjes së aplikimit të tyre dhe përpara ditës së zhvillimit të intervistës me gojë, të marrin informacion dhe të konsultohen me të dhënat mbi aktivitetin e shoqërisë, në mënyrë që të disponojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e platformës së tyre gjatë fazës së intervistës me gojë;

ii. t'i kërkojnë ERE-s informacionin e nevojshëm në rast se ERE nuk ka përfshirë në dosjen elektronike të të dhënave një informacion të caktuar, i cili konsiderohet i nevojshëm dhe në ndihmë të përgatitjes së platformës;



iii. të paraqesin ankesë në Bordin e ERE-s, në rast se ERE nuk i vë në dispozicion informacionin e nevojshëm/kërkuar apo nuk jep sqarim për këtë rast. Ankesa shqyrtohet nga Bordi i ERE-s, brenda afatit kohor që ka marrë ERE për të vendosur në dispozicion informacionin shtesë.

b) ERE është e detyruar që t'i vendosë në dispozicion aplikantit të interesuar informacionin e kërkuar dhe, njëkohësisht, ta bëjë pjesë të dosjes elektronike të të dhënave këtë informacion, në mënyrë që të marrin dijeni edhe aplikantët e tjerë që do të marrin pjesë në konkurrim. Në këtë rast, ERE shtyn afatin e përcaktuar për zhvillimin e intervistës me gojë, me një afat të arsyeshëm, por, në çdo rast, jo më pak se afati kohor që ka marrë ERE për të vendosur në dispozicion informacionin shtesë.

8. Praktikrat që do të ndiqen në procesin e shqyrtimit nga Bordi i ERE-s të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët aplikantë janë, si më poshtë vijon:

a) brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga plotësimi i afatit të përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 4, të këtij kreu, Bordi i ERE-s shqyrton paraprakisht dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët aplikantë, në mënyrë që të përzgjedhë ata që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta që janë në një listë zgjedhjeje, duke i akorduar secilit prej tyre nga 50 (pesëdhjetë) pikë. Shqyrtimi i dokumentacionit të bëhet edhe në prani të çdo kandidati, në rast se ai shfaq interes për të qenë prezent në procesin e shqyrtimit;

b) procesi i shqyrtimit të dokumentacionit reflektohet në një procesverbal, i cili, në përfundim, nënshkruhet nga anëtarët e Bordit të ERE-s;

c) ERE merr masa që të publikojë në faqen e saj të internetit listën e kandidatëve, të cilët kanë plotësuar kërkesat përkatëse dhe që do t'i nënshtrohen intervistës me gojë. Gjithashtu, ERE përcakton ditën përkatëse ku fton kandidatët e kualifikuar që t'i nënshtrohen fazës së dytë të intervistës me gojë, ku bëhet prezantimi i platformave mbi mënyrën e administrimit të shoqërisë së interesuar;

ç) kandidatët aplikantë, që nuk janë përfshirë në listën e zgjedhjes, kanë të drejtë që jo më vonë se 3 (tri) ditë kalendarike nga publikimi i listës së kandidatëve fitues, të depozitojnë një ankim në ERE mbi procesin e shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve. ERE shqyrton ankimin brenda 2

(dy) ditëve pune dhe i kthen një përgjigje me shkrim kandidatit të pakualifikuar.

9. Në datën e përcaktuar, Bordi i ERE-s zhvillon një intervistë të strukturuar me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, që kanë plotësuar kërkesat. Secili nga kandidatët prezanton platformën e tij për administrimin eficient të shoqërisë së interesuar, përfshirë edhe masat organizative që mendon që duhet të marrë në funksion të vazhdimësisë normale të aktivitetit.

10. Në përfundim të intervistave, Bordi i ERE-s analizon rezultatet e intervistës së strukturuar të çdo kandidati dhe platformën e paraqitur nga secili kandidat, duke i akorduar secilit prej tyre deri në 50 (pesëdhjetë) pikë, sipas sistemit të pikësimit të vendosur nga ERE. ERE ka të drejtë që të kryejë verifikime për vërtetësinë e dokumentacionit apo të informacionit të përfshirë në aplikim nga kandidatët.

Në përfundim të këtij procesi, ERE merr vendim për hartimin e listës me tri kandidaturat fituese, sipas pikëve që u janë akorduar. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe të bazohet në parimet e barazisë, të mirëbesimit dhe të mosdiskriminimit.

ERE, menjëherë pas marrjes së vendimit për hartimin e listës me tri kandidaturat e renditura të parat për detyrën e administratorit të përkohshëm, njofton me shkrim të gjithë kandidatët e përzgjedhur që iu nënshtrohen intervistës. Çdo kandidat jofitues, brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja e njoftimit, ka të drejtë që të kërkojë informacion shtesë mbi mënyrën e vlerësimit të kandidaturave dhe ERE duhet që të japë shpjegimet brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e kërkesës për informacion, duke bërë, nëse e vlerëson të drejtë, edhe ndryshim në listën e tri kandidatëve fitues, e cila konsiderohet listë përfundimtare.

ERE e përcjell listën përfundimtare të tri kandidaturave fituese në ministrinë përgjegjëse për energjinë.

### III. VENDIMI I EMËRIMIT

1. Ministri përgjegjës për energjinë, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e njoftimit nga ERE, ka të drejtën të përzgjedhë nga lista e kandidaturave fituese një të njërit prej tyre dhe ta përcjellë si propozim në ERE për të marrë vendim për emërimin e tij në detyrën e administratorit të përkohshëm të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca.



Vendimi i ERE-s regjistrohët në regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në vendimin e ERE-s për emërimin e administratorit të përkohshëm përcaktohen:

- a) arsyet për të cilat merret vendimi;
- b) detyrat kryesore të administratorit të përkohshëm.

2. Vendimi për emërimin e administratorit të përkohshëm botohet në Fletoren Zyrtare dhe në tri gazeta kombëtare, si dhe bëhet regjistrimi në regjistrin tregtar të shoqërive. ERE, për këtë vendim, njofton shoqërinë e interesuar dhe i kërkon shoqërisë që të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e tij. Vendimi për emërimin e administratorit të përkohshëm mund të ankimohet në gjykatën administrative kompetente nga palët e interesuara, në përputhje me afatet e parashikuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Administratori i përkohshëm përmbush të gjitha detyrimet e parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe mban përgjegjësi në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, për mënyrën e administrimit të shoqërisë gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm.

4. Paga e administratorit dhe shpenzimet për ushtrimin e funksioneve të tij përcaktohen nga ERE dhe përballohen nga shoqëria e interesuar, e cila është vendosur nën administrim të përkohshëm.

5. Me emërimin e tij, administratori i përkohshëm organizon punën për menaxhimin e aktivitetit të shoqërisë së interesuar, si dhe harton dhe paraqet për miratim në ERE një plan emergjent masash për përmirësimin e situatës financiare dhe për mbrojtjen sa më mirë të interesave të shoqërisë së interesuar, së cilës i është hequr licenca, dhe për kryerjen e aktiviteteve më të nevojshme të saj, në përmbushje të kërkesave të detyrimit të shërbimit publik për furnizim me gaz natyror.

6. Administratori i përkohshëm ushtron kompetencat vetëm në funksion të sigurimit të vazhdimësisë së aktivitetit të shoqërisë së interesuar. Për këtë arsye, administratori i përkohshëm nuk mund të marrë masa apo të hyjë në detyrime me palë të treta për marrjen apo përfitimin e shërbimeve që krijojnë kosto të konsiderueshme financiare për interesat e shoqërisë

dhe nuk përfaqësojnë nevoja emergjente për vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë së interesuar. Vetëm për raste përjashtimore, me miratimin paraprak të ERE-s dhe me kusht që të argumentohet efektiviteti në planin afatgjatë të veprimtarisë së shoqërisë, shoqëria mund të hyjë në marrëdhënie kontraktore për mallra dhe shërbime që kanë një vlerë të konsiderueshme.

Nisur nga specifika e shoqërisë së interesuar, ERE ka kompetencë që të përcaktojë, rast pas rasti, vlerat financiare të operacioneve financiare, për të cilat administratori i përkohshëm duhet të marrë miratim paraprak nga ERE.

#### IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Administratori i përkohshëm lirohet nga detyra, para përfundimit të afatit të administrimit, në rastet e mëposhtme:

a) me kërkesë të tij;

b) me vendim të Bordit të ERE-s, kur vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi, vendimit të emërimit të administratorit të përkohshëm dhe kuadrin ligjor e rregullator në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Enti Rregullator i Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

**Erion Braçe**



**VENDIM**  
**Nr. 703, datë 9.9.2020**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI  
 ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË  
 INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,  
 TË PRONËS SHTETËRORE ME  
 NOMENKLATURË K-34-112-127-D, ME  
 NUMËR PASURIE 402, 403, 404, 405, 406,  
 410 (NUMËR 19 SIPAS HARTËS SË  
 KADASTRËS DAMT), 411 (NUMËR 20  
 SIPAS HARTËS SË KADASTRËS DAMT),  
 412, 413 e 414, ZONA KADASTRALE NR.  
 2443, BASHKIA FIER, NJËSIA  
 ADMINISTRATIVE LIBOFSHË, DHE TË  
 PRONËS SHTETËRORE SIPAS HARTËS  
 TREGUESE, ME NOMENKLATURË K-  
 34-111-(111-D), ME NUMËR PASURIE  
 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1,  
 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1,  
 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, ZONA  
 KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E  
 RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE REMAS,  
 BASHKIA DIVJAKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, me nomenklaturë k-34-112-127-d, me numër pasurie 402, 403, 404, 405, 406, 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMT), 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMT), 412, 413 e 414, zona kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, Njësia Administrative Libofshë, dhe të pronës shtetërore me nomenklaturë k-34-111-(111-d), me numër pasurie 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, zona kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, me vendndodhje dhe sipërfaqe sipas anekseve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, do të përdoren për zhvillimin e projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltai, në zonën e Remas, Divjakë – Karavasta, Lushnjë.

3. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i lejohet vënia në dispozicion e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, shoqërisë së shpallur fituese nga procesi konkurrues i zhvilluar nga ministria, për të gjithë kohëzgjatjen e tij, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar.

4. Vendimi nr. 727, datë 8.12.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-112-127-d, me numër pasurie 402, 403, 404, 405, 406, 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMT), 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMT), 412, 413 e 414, zona kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, Njësia Administrative Libofshë, dhe të pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-111-(111-d), me numër pasurie 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, zona kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, në fondin e pasurive të paluajtshme, për mbështetjen e investimeve strategjike dhe vënien në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Albpanel”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**



## ANEKS I

ZONA KADASTRALE NR. 2443, BASHKIA  
FIER, NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBOFSHË

Nr. rendor Njësia administrative Zona  
kadastrale Numri i parcelës Sipërfaqe në m<sup>2</sup>

1. Libofshë 2443 402 96400
2. 403 98200
3. 404 92200
4. 405 96900
5. 406 97700
6. 410

(nr. 19 sipas hartës së kadastrës DAMI)

Nevojitet regjistrim fillestar

7. 411

(nr. 20 sipas hartës së kadastrës Nevojitet  
regjistrim fillestar DAMI)

8. 412 90800
9. 413 98300
10. 414 98300

## ANEKS II

ZONA KADASTRALE NR. 2085,  
KARAVASTA E RE, NJËSIA  
ADMINISTRATIVE REMAS

Nr. rendor Njësia administrative Zona  
kadastrale Numri i parcelës Sipërfaqe në m<sup>2</sup>

1. Remas 2085 220/1 33774
2. 220/3 64593
3. 221/1 18548
4. 221/3 148757
5. 224/1 166155
6. 225/1 149506
7. 226/1 144257
8. 227/1 14668
9. 227/3 64766
10. 228/1 16256
11. 228/3 90262
12. 229/1 11132
13. 229/3 98642
14. 230/1 81900
15. 231/1 72360
16. 232/1 34410

## VENDIM

Nr. 704, datë 9.9.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.4.2019,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
SHPRONËSIMIN PËR INTERES  
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE  
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,  
QË PREKEN NGA REALIZIMI I  
PROJEKTIT ‘REHABILITIMI I  
SEGMENTIT RRUGOR ‘PALLATI ME  
SHIGJETA – RRETHRROTULLIMI  
‘SHQIPONJA’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 231, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “tokë arë” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme prej 1 642 313 107.66 (një miliard e gjashtëqind e dyzet e dy milionë e treqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e shtatë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 642 313 107.66 (një miliard e gjashtëqind e dyzet e dy milionë e treqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e shtatë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

- 1 224 874 430.42 (një miliard e dyqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë pikë dyzet e dy) lekë,





nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

- 162 456 817.4 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë pikë katër) lekë, nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar;

- 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2020;

- 54 981 859.84 (pesëdhjetë e katër milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë tetëdhjetë e katër) lekë, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2021.”.

b) Vlera e shpenzimeve procedurale prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 231, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, i shtohet tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**



PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, PASURITË E PALUAJSTHME TË TË CILËVE, PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.04.2019 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, K, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJSTHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR “PALLATI ME SHIGJETA – RRETHROTULLIMI “SHQIPONJA”, I NDRYSHUAR

TË dhënat sipar PKM nr. 231, datë 17.04.2019											TË dhënat e ndryshuara dhe rëzta																			
Sip. Totale m2	Llaji Parurir e	TOKË TRUALL			TOKË ARË			OBJEKT BANIMI			VLERA Totale (LEKE)	Numri Parurir e	Sip. Totale m2	Llaji Parurir e	TOKË TRUALL			TOKË ARË			OBJEKT BANIMI			NDËRTESE SOC. EK			VLERA Totale (LEKE)	Shënime		
		Sipërfaqja rbr.(m2)	Qinimi (lakt/m2)	Vlera lekë	Sipërfaqja rbr.(m2)	Qinimi (lakt/m2)	Vlera lekë	Sipërfaqja rbr.(m2)	Qinimi (lakt/m2)	Vlera lekë					Sipërfaqja rbr.(m2)	Qinimi (lakt/m2)	Vlera lekë	Sipërfaqja rbr.(m2)	Qinimi (lakt/m2)	Vlera lekë	Sipërfaqja rbr.(m2)	Qinimi (lakt/m2)	Vlera lekë	Sipërfaqja rbr.(m2)	Qinimi (lakt/m2)	Vlera lekë				
200	arë				12	448	5,376				5,376																	0	kanfirmuar ASHK	
474	Truall ndortore	292	4242	1,238,664				227.2	53,500	12,155,200	13,393,864	315/546	474	Truall ndortore	292	4242	1,238,664				227.2	53,500	12,155,200	227			4,648,721	18,042,585	kanfirmuar ASHK	
104.3	arë				104.3	448	46,726.4				46,726.4	315/676	88.3	arë						88.3	448	39,558.40						39,558.4	kanfirmuar ASHK	
												315/675	16	arë						7.4	448	3,315.20						3,315.2	kanfirmuar ASHK	
376.7	Truall ndortore	376.7	4,242	1,597,961.4				217.2	53,500	11,620,200	13,218,161.4	315/678	302.7	Truall	302.7	4,242	1,284,052.40				217.2	53,500	11,620,200				12,967,883.4	kanfirmuar ASHK		
												315/677	74	Truall	15	4,242	63,630.00													kanfirmuar ASHK
<b>SHUMA (lekë)</b>											<b>26,664,127.8</b>												<b>31,053,342.1</b>							

Shënime: Efekti financiar shtesë është në shumën 4 389 214.3 lekë.



**VENDIM**  
**Nr. 706, datë 9.9.2020**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT**  
**KOMBËTAR TË**  
**DEINSTITUCIONALIZIMIT, 2020–2022,**  
**DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR**  
**ZBATIMIN E TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitucionalizimit, 2020–2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

**PLANI KOMBËTAR I**  
**DEINSTITUCIONALIZIMIT, 2020–2022**  
**KORRIK 2020**

**KONTEKSTI POLITIK, INSTITUCIONAL**  
**DHE SOCIAL**

Ky plan veprimi është përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në kuadër të Reformës së Shërbimeve të Kujdesit Social, dhe me mbështetjen teknike të UNICEF-it.

Dokumenti politik është konsultuar me grupet e interesit, shoqërinë civile, donatorë, partnerë dhe institucionet përgjegjëse në Shqipëri, duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit Sporteve dhe Rinisë, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Ministrinë e Brendshme dhe organizatat e tjera. Ky plan është hartuar në kuadër të detyrimeve, që rrjedhin nga Strategjia e Mbrojtjes Sociale (2020–2022).

Procesi i deinstitucionalizimit të sistemit të kujdesit për fëmijët, bazohet në ndryshimin e tipologjisë së ofrimit të shërbimeve, nga institucione rezidenciale në shërbime ditore, si dhe shërbime të tjera alternative, me bazë komunitare, duke u përqendruar në integrimin e fëmijëve në familje, qofshin ato biologjike apo kujdestare, në komunitete dhe shoqërinë e gjerë, duke respektuar interesin më të lartë të fëmijës.

“Çdo fëmijë, duhet të jetë në gjendje të gëzojë standard jetese të përshtatshëm, për zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe shoqëror, si dhe duhet të rritet në një mjedis familjar miqësor”, - bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës.

Plani i veprimit ndërthur politika dhe programe specifike, për të reduktuar institucionalizimin e fëmijëve, duke transformuar shërbimet e ofruara në institucionet rezidenciale, në shërbime multidisiplinare me bazë komunitare, të cilat ofrojnë përkujdesje alternative dhe të specializuara, duke ofruar mundësi për jetesë më të mirë dhe të pavarur.

Aktualisht grupet në nevojë për përkujdesje kalojnë vite të gjata në kujdesin institucional rezidencial. Disa prej tyre kanë aftësi të kufizuara fizike ose intelektuale, të tjerët vuajnë nga probleme të shëndetit mendor dhe të tjerë janë të moshuar, të braktisur apo të vetmuar, duke e vlerësuar si alternativën e vetme dhe të menjëhershme.

E drejta për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe për t'u përfshirë në komunitet në shtetin shqiptar, bazohet në vlerat e përbashkëta të respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Të gjithë personat kanë të drejtë të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të përfshihen në komunitet, të drejtën për të zgjedhur vendbanimin e tyre dhe ku dhe me kë jetojnë, si dhe të drejtën për të jetuar me dinjitet. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë në jetojnë në familje, qoftë familja e tyre ose familja kujdestare (nëse nuk kanë familje ose nëse rrezikohen në familjen e tyre). Këto të drejta përcaktohen në traktatet përkatëse ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përfshirë Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Kartën Sociale Evropiane të rishikuar, si dhe Kartën e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian.



Në praktikë, e drejta për të jetuar në komunitet kërkon disponueshmërinë e shërbimeve me bazë komunitare, të cilat ofrojnë mbështetjen që u nevojitet njerëzve dhe u mundëson atyre të marrin pjesë në jetën e përditshme. Në të kundërt, vendosja afatgjatë e personave në institucionet rezidenciale, mund të shihet si në kundërshtim me të drejtën e tyre për të jetuar në komunitet.

Fëmijët – me ose pa aftësi të kufizuara – janë veçanërisht të prekshëm ndaj efekteve të dëmshme të institucionalizimit, sepse institucionet nuk mund të ofrojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e tyre fizik, moral, psikologjik dhe emocional.

Në mënyrë që të “sigurojmë” që çdo fëmijë, që është rezident në institucionet rezidenciale apo është në rrezik të institucionalizimit, të gëzojë të drejtën për të jetuar në një familje të shëndetshme, me mirëqenien e nevojshme, në një komunitet të fuqizuar e miqësor për fëmijën, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) inicioi hartimin e Planit Kombëtar për Deinstitutionalizimin (PKDI).

MSHMS-ja, si fazë të parë të hartimit të këtij plani veprimi, së bashku me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, UNICEF-in dhe *Save the Children*, ka realizuar vlerësimin e 232 fëmijëve rezidentë në 9 institucione të shërbimeve të përkujdesjes (ISHP) publike. Për herë të parë janë vlerësuar plotësisht familjet e fëmijëve dhe rrethit të zgjeruar familjar të tyre. Ndërkohë janë identifikuar burimet financiare dhe njerëzore të nevojshme, për fuqizimin e fëmijës dhe të familjes për secilin fëmijë të vlerësuar, si dhe janë hartuar 232 plane individuale tranzicioni dhe zhvillimi për secilin prej tyre.

Në këtë kontekst janë identifikuar shërbimet mbështetëse vendore për fëmijën dhe familjen në të gjitha bashkitë, ku jetojnë familjet biologjike të fëmijëve rezidentë në 9 IPSH. Gjithashtu është krijuar rrjeti mbështetës institucional në nivel vendor, duke përfshirë në procesin e vlerësimit Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës, Shërbimin Social Rajonal, Shërbimet Shëndetësore dhe Arsimore vendore, e të tjera në secilën nga bashkitë. Të gjitha politikat dhe ndërhyrjet e parashikuara në këtë plan veprimi janë bazuar në gjetjet e vlerësimeve të realizuara.

Nisur nga fakti se institucionalizimi dhe deinstitutionalizimi janë procese që përfshijnë aktorë të ndryshëm në nivel qendror edhe vendor,

për hartimin e këtij dokumenti u kryen takime, tryeza konsultimi me institucione publike apo private, të përfshirë në këto procese.

Deinstitutionalizimi është procesi i planifikimit të integruar të transformimit të institucioneve, duke synuar reduktimin e numrit të fëmijëve në institucione deri në eliminimin e tyre, duke iu siguruar fëmijëve një ambient familjar, në interesin më të lartë të tyre.

Natyrshëm, procesi i deinstitutionalizimit gjendet i lidhur ngushtë me institucionalizimin dhe kujdesin alternativ. Për këtë fakt, kuadri ligjor që lidhet me mbrojtjen e fëmijës në përgjithësi dhe deinstitutionalizimin në veçanti, duhet analizuar në tërësi, duke përfshirë dhe analizuar të tërë procesin, nëpër të cilin kalon një fëmijë në nevojë për mbrojtje: nga faza e identifikimit, raportimit marrja e masave të mbrojtjes, kujdesi alternativ, institucionalizimi dhe dalja prej tij.

Duke qenë se familja është njësi bazë themelore e shoqërisë dhe mjedisi natyror për rritjen, mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijëve, plani i veprimit adreson masa specifike për të mundësuar ofrimin e shërbimeve alternative, në mënyrë që fëmija të mbetet ose të kthehet në kujdesin e prindërve të tij/saj ose te anëtarët e tjerë të ngushtë të familjes, kur është e përshtatshme.

Me miratimin e këtij plani veprimi synohet që brenda vitit 2022 të gjithë fëmijët rezidentë aktualë në 9 IPSH-të publike të jenë deinstitutionalizuar.

#### **Referenca me dokumentet strategjike dhe dokumente të BE-së**

PKDI-ja është hartuar/mbështetur në disa parime, që burojnë nga aktet kombëtare dhe ndërkombëtare, si:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
  - Konventa për të Drejtat e Njeriut;
  - Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
  - Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
  - Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
  - Rezolutën e Kombeve të Bashkuar për Kujdesin Alternativ;
  - Udhëzime të Bashkimit Evropian për të ndihmuar vendet e BE-së në procesin e mbylljes së institucioneve rezidenciale dhe zhvillimin e një game të shërbimeve me bazë komunitare, për të eliminuar nevojën për kujdes rezidencial;
  - Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2020–2023.
- Baza ligjore për hartimin e PKDI-së**



Aktualisht, mbrojtja dhe kujdesi ndaj fëmijës janë subjekt rregullimi i disa ligjeve dhe i akteve nënligjore, në varësi të nevojës dhe nivelit për ndërhyrje. Kryesisht, këto ligje janë:

- Kodi i familjes, ligji nr. 9062, datë 8.5.2003, i ndryshuar;

- Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës nr. 18/2017;

- Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror, nr. 121/2016;

- Ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, nr. 8153, datë 18.12.2006, i ndryshuar;

- Ligji për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit, nr. 9695 datë 19.3.2007, i ndryshuar;

*Akte në zbatim të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”:*

- Vendim nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”;

- Udhëzim nr. 556, datë 29.7.2019, “Për mënyrën e vendosjes në institucionet e përkujdesjes shoqërore, për fëmijën ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje”;

- Udhëzim nr. 584, datë 31.7.2019, “Për rregullat, procedurat dhe veprimet konkrete të autoriteteve të pushtetit qendror ose vendor, si dhe detyrimet e personelit mjekësor ose të profesionistëve të fushave të tjera, që lidhen me parandalimin ose trajtimin e rasteve të braktisjes së fëmijës në institucionet e kujdesit shëndetësor”;

*Akte në zbatim të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”*

- VKM nr. 136, datë 7.3.2018, “Për funksionimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”;

- VKM nr. 149, datë 13.3.2018, “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”;

- VKM nr. 518, datë 4.9.2018, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;

- Udhëzim nr. 689, datë 2.10.2018, “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”;

- VKM nr. 150, datë 20.3.2019, “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”;

- Udhëzim nr. 582, datë 18.12.2017, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, në qendrat shtëpi familje, për fëmijët 16–18 vjeç”;

- Udhëzim nr. 816, datë 27.11.2018, “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale”;

- Udhëzim nr. 394, datë 9.5.2019, “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare”.

Këto ligje dhe/ose aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre trajtojnë dhe rregullojnë aspekte apo faza të institucionalizimit, si dhe mbështetjen apo mbrojtjen që i jepet fëmijës, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme rezidenciale dhe/ose komunitare.

#### **KUADRI INSTITUCIONAL**

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** është institucioni kryesor, përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të mbrojtjes, kujdesit dhe integritetit të individëve dhe grupeve në nevojë.

**Shërbimi Social Shtetëror** është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjegjës për zbatimin e politikave të ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

**Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve** është institucioni përgjegjës për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

**Njësitë e Qeverisjes Vendore**, përfshirë këtu, strukturat e posaçme për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve (NJMF), si edhe njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit (NJVNR), janë përgjegjëse



për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

### **PJESA I: ANALIZA E SITUATËS**

1. Situata e fëmijëve rezidentë në institucionet e përkujdesjes shoqëror për fëmijë në Shqipëri (institucionet rezidenciale)

Në Shqipëri ekzistojnë 9 institucione të përkujdesjes shoqërore (IPSH) publike për fëmijë, 5 qendra zhvillimi, si edhe 18 institucione të përkujdesjes rezidenciale jopublike për fëmijë.

Në 9 IPSH-të publike për fëmijë aktualisht janë të vendosur 232 fëmijë: 3 prej IPSH-ve janë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror dhe 6 janë në varësi të dyfishtë midis MSHMS-së dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Varësia e dyfishtë e IPSH-ve aktuale sjell vështirësi në menaxhimin e përditshëm të tyre, në përzgjedhjen dhe emërimin dhe kërkesën e llogarisë për personelin e përkujdesjes, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në mirëqenien e fëmijëve.

Në 5 qendrat e zhvillimit janë aktualisht të vendosur 192 fëmijë: 2 institucione janë në varësi të Shërbimit Social Shtetëror dhe 3 në janë në varësi të dyfishtë midis MSHMS-së dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. MSHMS-ja do të kryejë një vlerësim të ngjashëm edhe për fëmijët e vendosur në qendrat e zhvillimit. Për këtë arsye vlerësimi i tyre është parashikuar si masë e veçantë në këtë plan.

Disa nga gjetjet kryesore të vlerësimit të kryer në fazën e parë janë:

- Përveç modelit të qendrave komunitare në disa bashki, mungojnë shërbimet të kostuara, të standardizuara, të specializuara për fuqizimin e familjeve, në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Numri më i lartë i fëmijëve në IPSH-të publike (mbi 90%) vijnë nga familje të pafuqizuara, të varfër ose në vështirësi ekonomike, prindër të papunë, prindër me probleme të shëndetit mendor dhe pa akses në shërbimet bazë.

- Pavarësisht se janë të parashikuara në VKM-në 518-4.9.2018 (shporta bazë e shërbimeve shoqërore), deri më sot në asnjë njësi të vetëqeverisjes vendore, nuk janë ngritur shërbimet e standardizuara dhe të kostuara për prindërimin pozitiv, trajtimin e varësive së prindërve, trajtimin e prindërve shfrytëzues abuzues dhe ose trajtimin e agresivitetit të të rriturve. Mbi 30% e fëmijëve

rezidentë janë viktima të neglizhimit, abuzimit dhe shfrytëzimit.

- Ka një numër shumë të vogël të familjeve kujdestare pa lidhje gjaku (më pak se 10 në të gjithë Shqipërinë). Asnjë njësi e vetëqeverisjes vendore, nuk ka hartuar dhe miratuar listën e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku. Ky fakt pamundëson deinstitutionalizimin e fëmijëve, të cilët nuk mund të kthehen në familjet biologjike apo në familje me lidhje gjaku.

- Mungesa e mekanizmave institucionalë, shërbimeve me bazë komunitare të standardizuara, në pjesën më të madhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, për parandalimin e deinstitutionalizimit.

- Është e qartë nga vlerësimi, por edhe nga studimet e tjera që fëmijët – si me dhe pa aftësi të kufizuara – janë, veçanërisht, të prekshëm ndaj efekteve të dëmshme të deinstitutionalizimit, sepse institucionet nuk ofrojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e tyre moral, psikologjik dhe emocional. 70% e fëmijëve të vlerësuar kanë vonesa në zhvillim sidomos atë ambiental.

- Shërbimet aktuale të ofruara në institucionet rezidenciale janë fokusuar te përkujdesja fizike dhe jo te zhvillimi individual. Gjithashtu, programet dhe shërbimet në institucionet aktuale rezidenciale janë ngritur për t'i shërbyer fëmijëve jetimë biologjike dhe jo fëmijëve të abuzuar, shfrytëzuar, neglizhuar apo me sjellje të dëmshme.

- Mungesa e shërbimeve mbështetëse dhe të specializuara për fëmijët me nevoja specifike në të gjitha institucionet rezidenciale, të tilla si: psikolog terapist, pedagogjist, logoped, fizioterapist etj.

- Në disa prej institucioneve rezidenciale, mungojnë psikologët dhe punonjësit socialë, duke cenuar direkt cilësinë e shërbimit psikosocial për fëmijët.

- Ka modele të suksesshme shërbimesh për fëmijën dhe familjen, të cilat ofrohen më së shumti nga organizatat joqeveritare, por edhe këto shërbime nuk janë të shtrira në të gjithë territorin, janë të pastandardizuara, si edhe janë me bazë projektesh.

- Fëmijët qëndrojnë për një periudhë të gjatë në institucione rezidenciale, si rezultat i paqartësive ligjore dhe i procedurave të ndjekura nga institucione të ndryshme, në lidhje me kujdestarinë e fëmijës.



- Gjithashtu, nga vlerësimi i realizuar në vitin 2019, ka dalë nevoja e koordinimit dhe e monitorimit të procesit të deinstitutionalizimit, në partneritet me institucionet e tjera publike, organizatat ndërkombëtare dhe vendore të përfshira në këtë proces. Gjithashtu është e domosdoshme inkurajimi i bashkive, që të parashikojnë në planet e tyre sociale, shërbime të përkujdesjes shoqërore miqësore për fëmijën dhe familjen në nivel vendor, me qëllim parandalimin dhe krijimin e kushteve për deinstitutionalizim.

### 1.1 Kultura e institucionale

Karakteristikat tipike të “kulturës institucionale” janë përshkruar dhe analizuar nga studiues katër dekada më parë, por edhe janë vërtetuar gjatë vlerësimit. Prej kohësh është argumentuar se kujdesi institucional ndan përdoruesit dhe ka tendencë të karakterizohet nga depersonalizimi (heqja e pasurive personale, shenjat dhe simbolet e individualitetit dhe njerëzimit), ngurtësia e rutinës (oraret fikse për zgjimin, ngrënien dhe aktivitetin, pavarësisht nga preferencat ose nevojat personale), trajtimi në bllok (trajtimi i njerëzve në grupe pa intimitet ose individualitet) dhe distanca sociale (simbolizon statusin e ndryshëm të stafit dhe banorëve). Banorët e institucioneve të tilla, zhvillojnë sjellje pasive (të deinstitutionalizuara) në përshtatjen e tyre me këto rutina, ndaj mërziutjes dhe mungesës së aktiviteteve kuptimplotë. Gjithashtu, punonjësit e përkujdesjes – siç e përshkroi Goffman, në rastin e një institucioni të shëndetit mendor – priren të bëhen më të “deinstitutionalizuara” me kalimin e kohës.

Në fund të fundit, praktikrat e kujdesit reflektojnë qëndrime dhe besime, të cilat konsideroheshin të domosdoshme për mbajtjen e stafit, për të përballuar detyrat e përcaktuara nga institucioni. Etika e kujdesit në institucionet rezidenciale ka qenë tradicionale paternaliste, se sa ndërvepruese. Në shumë lloje institucioneve (për personat me aftësi të kufizuara dhe ata me probleme të shëndetit mendor, por deri në një farë mase edhe tek ata për të moshuarit dhe për foshnjat), dominimi i profesionistëve mjekësorë dhe personelit të kujdesit shëndetësor vazhdon të ruajë distancën sociale, midis personelit dhe përdoruesit. Modeli mjekësor i kujdesit mbart rrezikun e zvogëlimit të individëve në diagnozën e tyre.

### 1.2 Deinstitutionalizimi

Nga studimet janë identifikuar evidenca të qarta në mbështetje të kalimit, nga kujdesi institucional në kujdesje alternative në mjedis familjar, të bazuara në komunitet (deinstitutionalizimi). Këto mund të japin rezultate më të mira për përdoruesit, familjet e tyre dhe stafin, ndërsa kostot e tyre janë të krahasueshme me ato të përkujdesjes institucionale, nëse krahasimi bëhet në bazë të nevojave të krahasueshme të banorëve dhe të cilësisë së krahasueshme të kujdesit. Përmirësimet e kushtueshme në kushtet fizike të institucioneve ekzistuese, të cilat shpesh propozohen si përgjigje ndaj gjetjeve të kujdesit nën standard, janë, gjithashtu, problematike, sepse nuk arrijnë të ndryshojnë kulturën institucionale dhe e bëjnë më të vështirë mbylljen e këtyre institucioneve në planin afatgjatë.

Janë identifikuar disa sfida kryesore të proceseve të deinstitutionalizimit. Këto përfshijnë përsëritjen e kulturës institucionale në shërbimet me bazë komunitare dhe këmbënguljen afatgjatë të shërbimeve paralele (mos mbyllja e institucionit). Në të kundërt, ekziston rreziku i dështimit për të krijuar shërbime të duhura me bazë komunitare, për shkak të objektivave dhe afateve jorealiste, që tejkalojnë aftësinë për zhvillimin e tyre. Kjo është, veçanërisht, e mundur të ndodhë, kur deinstitutionalizimi shihet kryesisht si një ushtrim për uljen e kostove.

Një grup i “Parimeve themelore të përbashkëta”, që duhet të zbatohen përgjatë deinstitutionalizimit, janë bazuar në praktikrat më të mira në këtë fushë, si dhe nga vlerësimi i sfidave kryesore të përmendura më lartë. Në përgjithësi, procesi duhet të respektojë të drejtat e përdoruesve, si dhe përdoruesit duhet të përfshihen në të gjitha proceset e vendimmarrjes. Duhet të ketë një sistem holistik të parandalimit të vendosjes në institucione. Shërbimet me bazë në komunitet duhet të krijohen paralelisht me mbylljen e institucioneve. Procesi kërkon një staf të mjaftueshëm dhe të trajnuar mirë, me aftësi të përshtatshme për kujdes të bazuar në komunitet, si edhe mbështetje adekuate për familjet. Si procesi i tranzicionit, ashtu edhe shërbimet që ekzistojnë kanë nevojë për kontroll të cilësisë me një fokus të qartë në arritjet personale të përdoruesit. Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm është i nevojshëm.

1.3 Kujdesi institucional rezidencial përkundrejt kujdesit alternative me bazë komunitare.



Në Bashkimin Evropian, në disa shtete anëtare ose rajone të tyre, institucionet e mëdha ekzistuese u zëvendësuan kryesisht nga ato më të vogla, diku tjetër deinstitutionalizimi i vërtetë ka ndodhur, gradualisht. Provat nga hulumtimi dhe vlerësimi i alternativave për kujdesin institucional, mbështesin kalimin në shërbime të kujdesit alternativ me bazë komunitare. Një numër i madh i studimeve kërkimore, tregojnë në mënyrë të dukshme rezultate më të mira për njerëzit që marrin shërbime perkujdesjeje, familjet e tyre dhe stafin që i mbështet ata.

Një përmbledhje e 73 studimeve për deinstitutionalizimin dhe jetesën e komunitetit të kryera në mes vitet 1990 e në vazhdim, kanë ilustruar ndryshimin midis shërbimeve në një sërë masash të ndryshme. Shumica e studimeve raportuan efekte pozitive në pesë nga gjashtë fushat (kompetencën dhe rritjen personale, sjelljeje sfiduese, pjesëmarrje të komunitetit, angazhim në veprimtari domethënëse dhe kontaktet me stafin).

Në përgjithësi, studimet në dispozicion konfirmojnë, që nëse ofrohen shërbime të një cilësie të lartë në komunitet, shumica e përdoruesve të institucionalizuar më parë kanë një preferencë të qartë për jetesën e komunitetit dhe shfaqin nivele më të larta të arritjeve personale dhe të përfshirjes sociale, me më pak probleme që lidhen me pasigurinë ose vetminë, sesa parashikohet.

Dallimet më të qarta në rezultate mund të tregohen në fushën e kujdesit për fëmijët (me aftësi të kufizuara, si dhe jo me aftësi të kufizuara). Është e dokumentuar qartë, që fëmijët që rriten në institucione rezidenciale shfaqin shkallë të shumë të lartë të dështimit në jetën pasuese prej të rrituri (alkoolizmi dhe varësia nga droga, sjellja kriminale, vetëvrasjet). Në të kundërt, të rriturit e rinj, që janë rritur në kujdestari alternative, kanë tendencë të integrohen në shoqëri pa vështirësi të konsiderueshme. Tani ekzistojnë prova në rritje, se efektet e deinstitutionalizimit për fëmijët – madje edhe kur institucionet në fjalë kanë kushte të mira materiale dhe staf të kualifikuar – mund të përfshijnë shëndet të dobët fizik, vonesa të rënda zhvillimi (paftësi të mëtejshme), si dhe dëme potencialisht të pakthyeshme psikologjike.

Për politikëbërësit, rezultatet e kujdesit institucional dhe të atij të bazuar në komunitet, trajtohen në mënyrë të pashmangshme në kontekstin e kostove. Komplexitetet e

marrëdhënies midis nevojave, kostove dhe rezultateve janë trajtuar më gjerësisht në raportin e DECLOC-së. Gjetjet mbizotëruese ishin se nuk ka prova, që modelet e kujdesit të bazuara në komunitet janë në thelb më të kushtueshme se institucionet rezidenciale, pasi krahasimi duhet të bëhet në bazë të nevojave të krahasueshme të banorëve dhe cilësisë së krahasueshme të kujdesit. Studime të tjera argumentojnë se kujdesi rezidencial institucional, në të vërtetë mund të jetë më i kushtueshëm se kujdesi me bazë komunitare, nisur nga vlerësimi i të gjitha kostove direkte dhe indirekte dhe i përfitimeve afatgjata të rritjes së pjesëmarrjes sociale.

2. Procesi i transformimit të shërbimeve të IPSH-ve përfshirë qendrat e zhvillimit

Institucionet e perkujdesjes shoqërore janë pjesë e planit të transformimit, në grup shërbimesh mbështetëse për fëmijën dhe familjen. Për secilin nga institucionet do të zhvillohet një plan i detajuar transformimi.

Për të planifikuar procesin e transformimit është ndërmarrë një vlerësim i institucioneve, i cili është akoma në proces, me qëllim për të vlerësuar: fëmijët e vendosur në këto institucione dhe planet për largimin e tyre (të vlerësuar në vazhdimësi); burimet njerëzore ekzistuese - kualifikimet, kompetencat dhe gatishmëria për të ndryshuar; burimet financiare ekzistuese – të buxhetuara dhe të shpenzuara, kategoritë e shpenzimeve, burimet e financimit, kosto për fëmijë; të drejtat e pronësisë, niveli i mirëmbajtjes, nevojat imediate; shërbimet e ofruara për fëmijët në IPSH; shërbimet ekzistuese në komunitete; linjat e menaxhimit dhe llogaridhënies; performanca e IPSH-ve.

Ekipet e vlerësimit kanë përfshirë: Punonjës socialë për shërbimet; punonjës të burimeve njerëzore për të vlerësuar stafin; punonjës të financave publike; psikologë; inxhinier; ekspert finance i administrimit dhe i menaxhimit; jurist me kohë të pjesshme; specialist nga shërbimi social shtetëror; si dhe përfaqësues të MSHMS-së;

“Disenjimi i modelit të shërbimit do të marrë parasysh gjetjet e këtyre vlerësimeve dhe do të realizojë zhvillimin e planit të transformimit”.

#### **Plani do të përfshijë:**

**Zhvillimin e modelit të shërbimit:** misionin e shërbimit; shërbimet që do të ofrohen; specifikimet teknike të shërbimit; struktura dhe personeli;





buxheti dhe burimet e financimit; dokumente ligjore dhe zhvillimi i politikave.

**Zhvillimin e dokumentacionit rregullator të entitetit shërbim ofrues:** Statuti për entin që do të ofrojë paketën e shërbimeve; Politikat e burimeve njerëzore; Politikat e financimit dhe administrimit; Politikat e mbrojtjes së fëmijës; Politikat e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe familjes

**Zhvillimin e planit të burimeve njerëzore informuar nga vlerësimi i burimeve njerëzore:** Plani i rivendosjes së stafit (kush tërhiqet me çfarë mbështetje, kush rivendoset në çfarë shërbime dhe me çfarë kushtesh); Libri i stafit (duke përfshirë të gjitha politikat e burimeve njerëzore mbi rekrutimin, trajnimet, performancën, supervizimin, *back-up*-i dhe emergjencat etj.); Përshkrim i punës dhe skema e linjës së menaxhimit; vlerësimi i nevojave për trajnim në të njëjtën linjë me përshkrimin e punës të hartuar për stafin e ri; trajnime dhe plane për rritje kapacitetesh për të gjithë stafin dhe çdo grup profesionistësh (fillestar dhe në vazhdim); mekanizmi i supervizimit profesional për stafin; përfundimi i marrëdhënieve të punësimit me një pjesë stafi dhe rekrutimi për stafin e ri; rekrutimi i stafit të ri dhe marrëveshjet kontraktuale; trajnim i stafit (menaxherë, supervizorë dhe punonjës) duke përfshirë trajnimin mbi menaxhimin.

**Zhvillimi i planit financiar të rialokimit:** Të ndërmarë kostimin e shërbimeve të reja të vendosura, kostimi për fëmijë për shërbim; zhvillimi i buxhetit vjetor për çdo shërbim dhe entitet; identifikimi i mekanizmave të zbatueshëm për rialokimin e burimeve ekzistuese, përfshirë autoritetin vendimmarrës financiar dhe bazën ligjore ose normative për aprovimin e financimit në një entitet të ri; zhvillimin e politikave financiare dhe administrative për entitetin.

**Zhvillimi i planit për përmirësimin e infrastrukturës:** (bazuar në vlerësim dhe nevojat për shërbime të reja): nevoja për ndryshimin e infrastrukturës; burimet e financimit për të kryer ndryshimet do të jenë nga fondi i investimeve, që planifikohet çdo vit për mirëmbajtjen e godinave.

**Strategjia e komunikimit e zhvilluar me mesazhe kyçe:** Lançimi/prezantimi i shërbimeve të reja; Krijimin e materialeve informuese në gjuhë miqësore për fëmijët dhe familjet; komunikim me publikun duke përdorur televizionin, radion dhe/ose medien sociale.

**Sistemi i menaxhimit të informacionit dhe mbledhja e të dhënave:** ZHVILLIMIN e sistemeve për mbledhjen e të dhënave; zhvillimi i një sistemi për mbledhjen e të dhënave miqësor për përdoruesit; integrimi i sistemit në sistemin ekzistues në nivel vendor dhe rajonal.

**Marrja e vendimeve për procesin e transformimit dhe shërbimeve të reja:** aprovimi i vlerësimit, modelit dhe planeve të transformimit; Mekanizmat dhe linjat e llogaridhënies: monitorimi, vlerësimi dhe inspektimi.

Nga vlerësimi i situatës, prioritet ka dalë shndërrimi i institucioneve dhe rialokimi i fondeve të shpenzuara aktualisht, për ngritjen e shërbimeve të mëposhtme (statike dhe të lëvizshme):

- Shërbimeve të emergjencës për fëmijën dhe nënën me fëmijë në nevojë për mbrojtje; (shërbim i munguar);

- Shërbimeve për fuqizimin dhe monitorimin e familjeve të fëmijëve në proces deinstitutionalizimi apo të deinstitutionalizuar;

- Shërbimeve mbështetëse dhe monitoruese për familjet kujdestare me apo pa lidhje gjaku;

- Shërbime burimore me personel për kujdes në familje;

- Shërbime të nivelit të tretë për shërbime të specializuara si logoped, pedagogjist, fizioterapist, psikologë terapistë etj.;

- Krijimi i apartamenteve gjysmë rezidenciale rinore.

Për sa u përket numri të punonjësve, kostove administrative, si edhe kostove të shërbimeve të reja, janë parashikuar të jenë brenda shumës së kostove aktuale, që shpenzohen nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucioneve të përkujdesjes shoqërore. Për sa i përket pilotimit, kostot do të mbulojnë nga donatorët dhe NJVQV do të ftohen të aplikojnë me projekte për shërbimet e reja të fondit social.

## **PJESA II: PARIMET, VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET STRATEGJIKE**

Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit, 2020–2022, është ndërtuar mbi parimet që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa për të Drejtën e Personave me Aftësi të Kufizuara, Karta Sociale Evropiane e rishikuar, Rezolutën e Kombeve të Bashkuar për Kujdesin Alternativ, si edhe



udhëzime të Bashkimit Evropian, për të ndihmuar vendet e BE-së në procesin e mbylljes së institucioneve rezidenciale dhe zhvillimin e një game të shërbimeve me bazë komunitare, për të eliminuar nevojën për kujdes rezidencial.

Parimet janë:

Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi: Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara etj.

**Mbrojtja:** Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhet të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë, bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.

**E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit:** Një mjedis i përshtatshëm duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.

**Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve:** Individët janë përgjegjës për jetën e tyre. Ata duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka vendosur.

**Përfshirja dhe integrimi.**

**Respektimi i të drejtave dhe nevojave.**

**Partneriteti:** koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.

**Cilësia e shërbimeve.**

**Standardet Kombëtare udhëheqin vendimmarrjen në nivel vendor.**

## 2.1 VIZIONI

Ndërtimi i një sistemi të përkujdesjes sociale të integruar funksionale dhe gjithëpërfshirëse, të deinstitutionalizuar, i cili parashikon politikat dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë fëmijët në nevojë, apo në risk nëpërmjet shërbimeve alternative të reja parandaluese dhe riintegruese, në një mjedis të përshtatshëm në familjen biologjike apo kujdestare të përkohshme, duke realizuar plotësisht potencialin e tyre.

## 2.2 Politikat dhe objektivat strategjikë

Deri në vitin 2022, çdo fëmijë në institucionet e përkujdesjes apo në rrezik deinstitutionalizimi, do të mbështetet me shërbime të reja alternative, në familje kujdestare apo shërbime të specializuara.

Plani i veprimit të deinstitutionalizimit identifikon qëllimet dhe objektivat e mëposhtëm, për realizimin e politikës:

**Deinstitutionalizimi, parandalimi dhe krijimi i shërbimeve alternative të fëmijëve të**

**moshës 0–18 vjeç, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.**

**Objektivi i parë strategjik është: Harmonizimi i sistemit të integruar ligjor, administrativ dhe procedural, që siguron zbatimin e interesit më të lartë të fëmijë**

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet dy objektiveve specifike:

Rishikimi i kuadrit ligjor të shërbimeve shoqërore, për mbrojtjen dhe përkujdesjen e fëmijëve. Rishikimi do të kryhet nëpërmjet masave të mëposhtme: Analizë/studim i kuadrit ligjor ekzistues, duke evidentuar nevojat për e ndryshimeve të nevojshme në legjislacion, duke përfshirë hartimin e udhëzimeve për profesionistët; hartimi i ndryshimeve ligjore, administrative dhe procedurale, bazuar në rekomandimet e studimit. nëpërmjet ekspertizës ligjore dhe tryezave teknike; konsultimi me ministritë e linjës, agjencitë zbatuese, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe grupet e interesit, i draft ndryshimeve ligjore të propozuara; dhe hartimi i akteve nënligjore/moduleve dhe udhëzuesve, sipas reformës së shërbimeve shoqërore për fëmijë.

Rregullimi i kuadrit financiar të shërbimeve të reja të përkujdesjes shoqërore të modeluara në kuadër të deinstitutionalizimit. Rregullimi do të përfshijë masat e mëposhtme: hartimi dhe kostimi i paketës minimale të shërbimeve komunitare për nënën dhe familjen në bashki, bazuar në praktikat aktuale, duke standardizuar dhe kostuar bazuar në nevojat e familjeve dhe të fëmijëve; hartimi dhe kostimi i modeleve të reja të shërbimit, sipas reformës së shërbimeve shoqërore për fëmijë; hartimi dhe kostimi i programit të standardizuar të ribashkimit të fëmijës me familjen, bazuar në eksperiencat e deritanishme të aktorëve të ndryshëm; dhe hartimi i udhëzuesit për bashkitë, për të planifikuar dhe aplikuar në kuadër të fondit social, për ngritjen e shërbimeve që synojnë ribashkimin e fëmijës.

**Objektivi i dytë strategjik është: Shërbime sociale dhe të integruara për ndërhyrje të hershme dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga mjedisi familjar (përfshirë fëmijët me AK)**

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet tre objektiveve specifike:

Moratorium për deinstitutionalizimin e fëmijëve: zbatimi i këtij objektivi do të mundësohet nga: Moratorium për deinstitutionalizimin e fëmijëve 0–3



vjeç; moratorium për institucionalizimin e fëmijëve 0–6 vjeç (do të fillojnë në 2 ISHP-të, ku do të pilotohet transformimi Korçë, Vlorë). MSHMS-ja dhe SHSSH-ja do të marrin të gjitha masat, që gjithë fëmijët në rrezik të lartë nga zonat në fjalë, të kenë akses në shërbime të kujdesit rezidencial të menjëhershme, deri sa të ngrihen shërbimet e kujdesit alternativ.

Zhvillimi i mekanizmit/ve institucionalë për parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve. Mekanizmat institucionalë për parandalimin e institucionalizimit do të ngrihen duke: Hartëzim i shërbimeve të kujdesit për fëmijë në bashkitë e origjinës së fëmijëve, të vendosur aktualisht në IPSH-të publike dhe qendrat e zhvillimit; standardizimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kornizës së vlerësimit të unifikuar për fëmijën dhe familjen, si dhe mbështetja e zbatimit të saj në nivel kombëtar; ngritja e komisioneve bashkiake /rajonale dhe/ose ngarkimi i detyrave për parandalimin e institucionalizimit dhe ofrimin e kujdesit alternativ, aty ku këto komisione janë ngritur, për të mbështetur Strukturën e Posaçme për Shërbimet Sociale në bashki, me vendimmarrjen për ndarjen e fëmijës nga familja dhe vendosjen e saj/tij në kujdes alternativ; analizimi i rezultateve të vlerësimit, të të gjithë fëmijëve të vendosur në IPSH-të publike dhe identifikimi i drejtimeve strategjike për transformimin e IPSH-ve, në qendra shërbimesh përkujdesjes alternative, duke priorizuar fëmijët e moshës 0–6 vjeç; dhe rishikimi i kriterëve dhe i procedurave të licencimit për OJF-të, që ofrojnë shërbime të kujdesit social rezidencial dhe miratimi i tyre me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ndërtimi dhe funksionimi i shërbimeve psikosociale me bazë komunitare, mbi parandalimin e braktisjes së fëmijës, përfshirë dhe fëmijët PAK, nëpërmjet: zhvillimi dhe ngritja e shërbimeve psikosociale të kostuara dhe standardizuara, me qëllim identifikimin e fëmijëve në rrezik braktisjeje, ndërhyrjen e hershme, ofrimi i mbështetjes brenda maternitetit dhe ndërveprimi me komunitetet, për të mbështetur prindërit me fëmijë foshnja, në qendrat shëndetësore, konsultore dhe maternitetet e qyteteve kryesore (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë, Vlorë, Berat). Zhvillimi dhe ngritja e këtyre shërbimeve do të bazohet në eksperiencat dhe praktikatat më të mira vendore dhe ndërkombëtare; hartimi i

përshkrimeve të punës për personelin e shërbimit psikosocial në maternitete; zhvillimi dhe ngritja e një mekanizmi efektiv referimi dhe protokollit të të punuarit së bashku për identifikimin e hershëm të rasteve të braktisjes së fëmijëve të porsalindur; hartimi i një programi mbështetës për kategorinë e nënave, që rrezikojnë braktisjen e fëmijës, përfshirë strehimin, punësimin, arsimimin, edukimin për prindërim, kujdesin e hershëm për fëmijën, përfshirë fëmijët me AK. Programi do të jetë pjesë e paketës së shërbimeve për fuqizimin e familjes; modelimi dhe ngritja e shërbimeve sociale specifike për nënën dhe fëmijën me bazë komunitare në të paktën 3 bashki (Korçë, Vlorë, Tiranë) të konsultuara me grupet e interesit, p.sh. PAK, Romët etj.; hartimi dhe pilotimi i një modeli shërbimi ditor, si dhe mundësitë për të mbështetur familjen, shërbim të specializuar për fëmijët. (Qendra e Zhvillimit Durrës); Hartimi i planit për replikimin e modeleve të zhvilluara në nivel kombëtar; si dhe vlerësim dhe studim-fizibiliteti, për mundësinë e ngritjes së shërbimeve me bazë komunitare (një njësi shërbimi) dhe modelimi i shërbimit për fëmijët me aftësi të rënda fizike dhe intelektuale, në një mjedis të përbashkët, jo të veçuar nga fëmijët e tjerë.

**Objektivi i tretë strategjik është: Sigurimi i interesit më të lartë të fëmijëve (përfshirë fëmijët me AK) rezidentë në IPSH-të publike dhe Qendrat e Zhvillimit**

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet pesë objektivave specifike:

Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijëve rezidentë në IPSH dhe Qendrat e Zhvillimit dhe zbatimi i planeve individuale të zhvillimit, për gjithësecilin fëmijë, duke: koordinimi me drejtuesit e IPSH-ve dhe qendrat e zhvillimit, publike dhe private, për fëmijët 0–18 vjeç, me bashkitë, partnerët dhe strukturat e SHSSH-së, për sigurimin e mirëqenies dhe deinstitutionalizimin e fëmijëve; vlerësimi individual i gjithësecilit fëmijë dhe familjeve, rishikimi i vlerësimeve ekzistuese dhe i planeve individuale të zhvillimit dhe përkujdesjes (çdo 6 muaj), duke identifikuar mundësitë e ribashkimit; Vlerësimi i fëmijëve me AK dhe i familjeve të tyre për të identifikuar mundësitë e deinstitutionalizimit, për të informuar zhvillimin e shërbimeve të ardhshme me nevojat e fëmijëve dhe familjeve. Hartimi i planeve individuale të zhvillimit dhe përkujdesjes; mbështetje e IPSH-ve dhe e



qendrave të zhvillimit, për zbatimin e planeve individuale të zhvillimit, përkujdesjes dhe ribashkimit, duke e shoqëruar me përpjekjet për fuqizimin e familjeve; deinstitutionalizimi i fëmijëve me dhe pa AK nga IPSH-të publike dhe qendrat e zhvillimit (IR), nëpërmjet bashkimit me familjet biologjike, kujdesit alternativ apo i birësimit; dhe mbështetja e rasteve të identifikuar për ribashkim me familjen biologjike – faza e parë.

Transformimi gradual i 9 IPSH-ve (institucione të shërbimeve të përkujdesjes) publike në shërbime multidisiplinare e multifunkionale për fëmijën dhe familjen), duke zbatuar interesin më të lartë të fëmijës nëpërmjet: vlerësimi i IPSH-ve (fëmijë dhe familje, kapacitete të stafit, financat, infrastruktura, programi, pajisjet dhe performanca institucionale); hartimi i një programi konkret, me 9 plane individuale transformimi të 9 institucioneve, bazuar në rekomandimet e vlerësimit të kryer; zhvillimi i modeleve të shërbimeve të reja, që do të ofrohen në atë ardhmen nga institucionet aktuale rezidenciale: 1. Shërbime për fuqizimin e familjeve “për rastet komplekse”; 2. Qendër mbështetëse për kujdesin alternativ; 3. Zhvillimi i modelit të kujdesit alternativ profesional/profesionist; 4. Zhvillimi i mekanizmit për parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja biologjike; 5. Shërbime të strehimit emergjent të sigurt, bazuar në nevojat dhe kapacitetet. Mbështetje për rialokimin e burimeve financiare dhe njerëzore për transformimin e IPSH-ve të shërbimit të reja; zhvillimi dhe aplikimi i protokolleve dhe i mekanizmave të llogaridhënies për shërbimet të reja (të integruara në sistemin aktual të përkujdesjes shoqërore); dhe pilotimi i transformimit të IPSH-ve në shërbime të reja, në Korçë dhe Vlorë.

Zhvillimi i modeleve të shërbimeve për fuqizimin e familjeve për të parandaluar ndarjet e fëmijës nga familja dhe promovimin e ribashkimit familjar, në vijim të programit të transformimit të IPSH-ve. Modelet e shërbimeve do të zhvillohen duke: modeluar, kostuar dhe pilotuar përfaqshen për fuqizimin e familjes dhe ribashkimit me familjen biologjike, duke siguruar interesin më të lartë të fëmijës, në bashkëpunim me fëmijën, familjen dhe institucionet përgjegjëse; Modelimi, kostimi dhe pilotim i ngritjes së shërbimeve multidisiplinare për mbështetjen e familjeve në IPSH-të, që do të transformohen në fazën e pilotimit, për të ofruar mbështetje komplekse për familjet; Monitorimi i

procesit të ribashkimit, progresit të fëmijës dhe familjes, nëpërmjet këshillimit, advokimit dhe prindërimit pozitiv; si dhe analiza e praktikave, mësimave të nxjerra, për të informuar politikatat vendore dhe qendrore, dhe fuqizimin e familjeve për përkujdesjen ndaj fëmijës. Të gjitha shërbimet e mësipërme do të ngrihen, duke u bazuar në praktikatat ekzistuese, do të këshillohen me aktorët e fushës, si edhe me përfituesit e tyre. Pas periudhës së pilotimit, këto modele do të standardizohen.

Hartimi dhe zbatimi i modelit të shërbimit për jetesë gjysmë të pavarur dhe të pavarur (për fëmijët mbi 14 vjeç përfshirë fëmijët me AK), duke: modelimi, kostimi i shërbimit të jetesës gjysmë të pavarur dhe të pavarur (përfshirë kosto, modalitete, praktika dhe udhëzues), bazuar në eksperiencën e deritanishme të IPSH-ve aktuale dhe të fshatit SOS; konsultimi i modelit të shërbimit me organizata të mundshme dhe bashki të mundshme (psh. Tiranë, Saranda, Shkodër); Hartimi i programit (për mbështetjen financiare, strehimi, punësim, arsim dhe mbështetja me ekip profesionistësh) për të rinjtë që dalin nga IPSH-të; ngritja dhe pilotimi i shërbimit të jetesës gjysmë të pavarur, për fëmijët e rritur (14–18 vjeç); realizimi i vlerësimeve individuale për çdo fëmijë dhe familjet e tyre, si dhe analizimi i mundësisë së jetesës gjysmë të pavarur ose të pavarur, përmes një programi mbështetës fuqizimi; hartimi i planeve individuale të zhvillimit dhe i përkujdesjes, të kostuara, përfshirë mundësitë e ribashkimit me familjen biologjike, për fëmijët dhe të rinjtë në jetesë gjysmë të pavarur dhe të pavarur; Mbështetje, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të planeve individuale zhvillimit dhe të përkujdesjes dhe largimit të fëmijëve në kujdes gjysmë të pavarur dhe të pavarur për gjithë secilin fëmijë të vlerësuar; vlerësim i impaktit të këtij modeli dhe mundësia për ta shtrirë në institucionet e tjera; takime konsultative me drejtorët e qendrave të zhvillimit dhe OJF-të, për draftimin e moduleve/kurrikulave, në lidhje me vetëkujdesjen dhe jetesën gjysmë të pavarur, për fëmijët më aftësi të kufizuara. Ngritja e një grupi teknik të nivelit të lartë për hartimin/rishikimin e moduleve/kurrikulave, në lidhje me jetesën e pavarur të fëmijëve me aftësi të kufizuara; vlerësimi i nevojave të personelit për të zhvilluar aftësi, për të mbështetur/ndihmuar fëmijët për jetesën e pavarur dhe gjysmë të pavarur; mbështetja dhe monitorimi në vazhdimësi, si dhe



evidentimi/vlerësimi i impaktit të trajnimit të fëmijët; si dhe vlerësimi i ecurisë së fëmijëve me çdo institucion, familjet dhe hartimi i një plani në vazhdimësi, për të forcuar jetesën gjysmë të pavarur.

Fuqizimi i zbatimit të kujdesit alternativ për të gjithë fëmijët me fokus të veçantë fëmijët 0–6 vjeç, si pjesë e IPSH-ve që do të transformohen nëpërmjet: mbështetja e 4 njësive të qeverisjes vendore për të zhvilluar dhe integruar shërbimet e kujdesit alternativ në planet e tyre sociale (planet vendore të përkujdesjes shoqërore); Mbështetja e njësive të qeverisjes vendore për riorganizimin e strukturave e nevojshme institucionale (rishikim i përshkrimeve të punës), që do të bëjnë të mundur ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes alternative, të mbështetura nga UNICEF në periudhën e pilotimit (planifikimin e referimit, modelin e përkujdesjes, vlerësimin, trajnimin e familjeve, vendimmarrjen për institucionalizimin e fëmijëve, kushtet e kontratës etj.), duke prioritetizuar fëmijët 0–6 vjeç; hartimi i metodologjisë dhe i instrumenteve për shërbimet e përkujdesjes alternative profesionale, në bashkëpunim me aktorët përgjegjës; parashikimin e numrit të kujdestarëve alternativë për secilën bashki të nevojshëm, për t'u rekrutuar, bazuar në hartën e bashkive të origjinës të fëmijëve të vendosur aktualisht në IPSH; vlerësimi i kujdestarëve alternativë të mundshëm; miratimi i kujdestarëve alternativë nga komisionit/skuadra multidisiplinare për shërbimet sociale (në bashkitë përkatëse ose në nivel rajonal në katër zona). Këtyre komisioneve mund t'u ngarkohen dhe detyrat e parandalimit të ndarjes së fëmijës nga familja; vendosja e fëmijëve në familjet kujdestare, sipas VKM-së nr. 89 (fëmijët 0–3 vjeç janë prioritet); monitorim i vazhdueshëm i familjeve dhe i fëmijëve të tyre, të vendosur në familjet e përkujdesjes alternative; qendrat për mbështetjen e familjeve të përkujdesjes alternative mbështesin në vazhdimësi familjet kujdestare dhe NJMF-të do të mbështesin fëmijët e vendosur në përkujdesje alternative, si dhe do të punojnë për riintegrimin ose birësimin, gjë që është shumë mirë për ndarjen e detyrave dhe përjashtimin e konfliktit të interesit; punë për zgjidhjen e statusit të kujdestarisë së fëmijës/braktisje; hartimi i planeve të përthershme të fëmijëve në kujdes alternativ; puna për zbatimin e planit afatgjatë të përkujdesjes për secilin fëmijë, përfshirë birësimin; sigurimi i

aksesit të fëmijëve të vendosur në përkujdes alternativ dhe i familjeve kujdestare në shërbime mbështetëse komunitare; inspektimi periodik i shërbimeve të kujdesit alternativ nga inspektorati përgjegjës për shërbimet shoqërore.

**Objektivi i katërt strategjik është: Ngritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi i institucioneve dhe publikut të gjerë për mirëqenien e fëmijëve dhe deinstitutionalizimin**

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet dy objektivave specifike:

Ngritja e kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe private për deinstitutionalizimin në vazhdimësi nëpërmjet: hartimi i një manuali për praktikën e mira për deinstitutionalizimin për bashkitë; orientimi dhe mbështetja e bashkive në vetadministrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të ofruara në qendra publike në njësitë e tyre; zhvillimi dhe akreditimi i programeve të trajnimit aktuale dhe të reja, për të siguruar zbatimin e përfaqësive dhe modeleve të reja dhe të standardizuara të shërbimeve; hartimi dhe miratimi/akreditimi i paketës së trajnimeve për përkujdesjen alternativë – për trajnimin fillestar dhe në vazhdim, bazuar në kurrkualat aktuale në përdorim; hartimi i modulit/kurrikulës së trajnimit për kujdesin për veten dhe jetesën gjysmë të pavarur, përfshirë fëmijët të cilët jetojnë pranë qendrave të zhvillimit; rishikimi i kurrikulës dhe i vlerësimit të nevojave nga ana e MSHMS-së dhe rishikimi/finalizimi, sipas komenteve dhe sugjerimeve për fëmijët rezidentë në qendrat e zhvillimit; ngritja e kapaciteteve të bashkive për të zbatuar programe për fuqizimin e familjes (planifikimi, buxhetimi dhe mobilizimi i burimeve komunitare); vazhdimi i rritjes së kapaciteteve të strukturave qendrore dhe vendore për deinstitutionalizimin; prezantimi dhe orientimi i programit të trajnimeve për punonjësit socialë dhe psikologët. Ngritja e kapaciteteve të të gjithë aktorëve, të përfshirë në parandalimin e braktisjes së foshnjave, nëpërmjet sesioneve informuese, trajnimeve fillestare e në vazhdim, zhvillimi dhe ofrimi i supervizimit dhe i mentorimit profesional; trajnime të stafit, që do të ofrojë shërbimet, si dhe ritrajnime të stafit aktual të IPSH-ve (zhvillimi i fëmijës, menaxhimi i ndryshimit, ofrimi i shërbimeve të reja); organizimi i trajnimit të personelit në çdo qendër zhvillimi; organizimi i



sesioneve të trajnimeve me kujdestarë alternativë të mundshëm; hartimi i një udhëzuesi praktik dhe rritja e kapaciteteve të SHSSH-së për monitorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror; si dhe mentorim dhe supervizion profesional në vazhdim për IPSH-të, bashkitë dhe SHSSH-në.

Hartimi dhe zbatimi i strategjisë kombëtare të komunikimit për deinstitutionalizimin duke hartuar dhe miratuar strategjinë kombëtare të komunikimit për deinstitutionalizimin; organizuar Konferencë ose takim ndërinstitutional i nivelit të lartë për njohjen me planin kombëtar dhe çështje të deinstitutionalizimit; ndërgjegjësimi i bashkive dhe i aktorëve në nivel vendor për rëndësinë e ngritjes dhe funksionimit të modeleve të kujdestarisë alternative; organizimi i fushatave të komunikimit dhe i takimeve informuese me institucionet, komunitetet dhe njerëzit e interesuar, si dhe organizimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere, në vazhdimësi, për parandalimin e braktisjes/lënies dhe mbështetjen e hershme. Zbatimi në tërësi i strategjisë dhe i aktiviteteve të komunikimit.

### **Objekti i pestë strategjik është: Koordinimi në nivel kombëtar dhe monitorimi i zbatimit të planit kombëtar të deinstitutionalizimit**

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet dy objektivave specifikë:

Koordinimi i të gjitha strukturave shtetërore për deinstitutionalizimin e fëmijëve nga IPSH-të publike (përfshirë fëmijët me AK) dhe monitorimi i planit nëpërmjet: ngritjes së komitetit drejtues ndërinstitutional për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit; ngritja e strukturave të koordinimit në nivel vendor në çdo bashki që ka IPSH (6 bashki); takimet e strukturave koordinuese në nivelin vendor çdo muaj; takime periodike të grupit teknik të nivelit të lartë për deinstitutionalizimin; koordinim ndërinstitutional rast pas rasti sipas nevojës; si dhe koordinimi i punës së përbashkët, për ngritjen e shërbimeve ditore dhe shërbimeve të tjera me bazë komunitare, për fëmijët me dhe pa AK dhe prindërit e tyre.

Monitorimi i planit të veprimit nisur nga: raporte progresi mujore nga njësitë e koordinimit në nivel vendor për MSHMS-të dhe sipas nevojës; hartimi i raporteve të progresit, vjetore, për sfidat dhe mësimet e nxjerra për rolin e punonjësit social, fushatat e komunikimit, funksionimin e

mekanizmit të referimit etj. dhe ndarja me MSHMS-në, SHSSH-në; monitorimi dhe vlerësimi në vazhdim i shërbimeve të reja; hartimi i kalendarit të takimeve të rregullta në çdo bashki, për të diskutuar sfidat dhe arritjet; dokumentimi i rasteve dhe i praktikës; monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit dhe ndikimit të shërbimit, për të siguruar qëndrueshmërinë dhe mundësinë e replikimit në nivel kombëtar; dhe raportprogresi vjetor i ecurisë së Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit.

### **2.3 Treguesit e performancës dhe rezultatet e pritshme**

1. 46 fëmijë mund të kthehen në familjet biologjike duke mbështetur dhe fuqizuar familjet me shërbime psikosociale, mundësi strehimi dhe mundësi punësimi.

2. 39 fëmijë të birësuar.

3. 34 fëmijë të vendosur në shërbimet e kujdesit alternativ (familje kujdestare me dhe pa lidhje gjaku).

4. 20 fëmijë të aftë për jetesë të pavarur.

5. Ulje e numrit të fëmijëve të institucionalizuar deri në 50%.

6. Transformimi i dy institucioneve për fëmijë 0–6 vjeç (Korçë dhe Vlorë) në grup shërbimesh për mbështetjen e fëmijës dhe familjes.

7. Rritje e numrit të familjeve kujdestare me 50%.

8. Ngritja e 3 shërbimeve me bazë komunitare (qendra) për të ofruar paketë shërbimesh mbështetëse, si fuqizim familjeje, këshillim, aftësim prindëror.

9. Ngritje e shërbimit të jetesës gjysmë të pavarur dhe të pavarur në tri bashki: Tiranë, Sarandë dhe Shkodër.

10. Ngritja e 4 shërbimeve për parandalimin e ndarjes së fëmijës nga nëna, në 4 maternitete kryesore.

11. Ngritja e qendrave për mbështetjen e përkujdesjes alternative në 4 institucione të përkujdesjes shoqërore, përfshirë përkujdesjen alternative profesionale.

## **3. MONITORIMI DHE LLOGARIDHËNIA**

Përveç masave të parashikuara në objektivin strategjik 5, monitorimi i Planit të Veprimit të Deinstitutionalizimit do të kryhet edhe nga grupi tematik për përfshirjen sociale, brenda strukturës së grupit për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP) të miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr.



157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Grupi i Treguesve dhe i Integritetit të Statistikave (GTIS) do të bashkërendojë aktivitetin monitorues me Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

I gjithë procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore kombëtare përgjegjëse për shëndetin dhe mbrojtjen sociale (përfshi Shërbimin Social Shtetëror dhe NJQV-të), arsimin, strehimin, të drejtat e njeriut, institucionet e qeverisjes vendore, INSTAT, shoqëria civile në cilësinë e ofruesit të shërbimeve.

Draftet e raporteve njëvjeçare të monitorimit do të përgatiten në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe do të miratohen nga GMIP.

Monitorimi do të bazohet në ndjekjen e treguesve të detajuar për secilin objektiv specifik dhe analizimin e progresit dhe të problemeve në secilën prej politikave prioritare. Raporti i standardizuar do të përmbajë fakte dhe të dhëna të standardizuara.

Gjithashtu, monitorimi i planit të veprimit do të bëhet dhe nisur nga: raportprogresi mujor, nga njësitë e koordinimit në nivel vendor për MSHMS dhe sipas nevojës; hartimi i raporteve të progresit vjetore për sfidat dhe mësimet e nxjerra për rolin e punonjësit socialë, fushatat e komunikimit, funksionimin e mekanizmit të referimit etj. dhe ndarja me MSHMS-në, SHSSH-në; monitorimi dhe vlerësimi në vazhdim i shërbimeve të reja; hartimi i kalendarit të takimeve të rregullta në çdo bashki për të diskutuar sfidat dhe arritjet; dokumentimi i rasteve dhe i praktikës; monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit dhe ndikimit të shërbimit, për të siguruar qëndrueshmërinë dhe mundësinë e replikimit në nivel kombëtar; dhe raportprogresi vjetor i ecursisë së Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit.

#### 4. BURIMET E FINANÇIMIT

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e masave administrative dhe arritjen e objektivave të këtij plani është 65,864,000 lekë. Burimet e përcaktuara për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për programet buxhetore “Përkujdesja sociale” dhe “Planifikim, administrim dhe menaxhim” mbulojnë rreth 48% të kostos së përlogaritur për këtë plan, përkatësisht 31,888,000 lekë. Kostoja financiare e mbuluar nga buxheti i miratuar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për çdo vit buxhetor përkatës, është e përfshirë brenda parashikimeve të tavanëve të shpenzimeve buxhetore për periudhën afatmesme. Nevojat për fonde, për periudhën 2020–2022, janë programuar në përputhje me kuotat tavan të projektbuxhetit afatmesëm (PBA 2020–2022). Nga programi buxhetor “Përkujdesja sociale”, pjesë kryesore të fondit për zbatimin e planit është dhe produkti për “Fondin social”, ku njësitë vendore nëpërmjet financimit nga ky fond do të ofrojnë shërbimet e nevojshme sociale, në zbatim të këtij plani. financimi nga fondi social përbën rreth 23% të burimeve nga buxheti i programit “Përkujdesja sociale”.

Burimet financiare nga donatorët mbulojnë rreth 52% të kostos së planit, përkatësisht rreth 33,976,000 lekë, kryesisht nga UNICEF, *Save the Children* dhe donatorë të tjerë, të cilët kanë shprehur gatishmërinë për të mbështetur financiarisht zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit pas miratimit të tij, jo vetëm për shumën në fjalë, por edhe në kostot shtesë që mund të kenë shërbimet e reja.

Ky bashkëpunim është në kuadër të angazhimeve të përcaktuara në Memorandumin e Mirëkuptimit, për vendosjen e bashkëpunimit institucional midis Palëve, për zbatimin e Planit të Veprimit për Deinstitutionalizimin, me nr. protokollit 6706, datë 22.11.2018.

Kostimi i Planit të Deinstitutionalizimit është realizuar bazuar në metodologjitë dhe praktikën e planifikimit buxhetor.



Politikat sektoriale Objektivat	A. Buxheti nevojshëm (në mijë lek)	B. Buxheti shtetit i planifikuar (në mijë lek)	C. Donatorë (në mijë lek)	D. Hendek financiar (në mijë lekë) D=A-(B+C)
1. Harmonizimi i sistemit të integruar ligjor, administrativ dhe procedural, që siguron zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës	1790	407	1383	0
1.1 Rishikimi i kuadrit ligjor të shërbimeve shoqërore, për mbrojtjen dhe përkujdesjen e fëmijëve.	896	311	585	0
1.2 Rregullimi i kuadrit financiar të shërbimeve të reja të përkujdesjes shoqërore të modeluara në kuadër të deinstitutionalizimit	894	96	798	0
2. Shërbime sociale dhe të integruara për ndërhyrje të hershme dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga mjedisi familjar (përfshirë fëmijët me AK)	5519	1659	3860	0
2.1 Moratorium për institucionalizimin e fëmijëve	96	96	0	0
2.2 Zhvillimi i mekanizmit/ve institucional/ë për parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve	976	311	665	0
2.3. Ndërtimi dhe funksionimi i shërbimeve psikosociale me bazë komunitare mbi parandalimin e braktisjes së fëmijës, përfshirë dhe fëmijët PAK	4447	1252	3195	0
3. Sigurimi i interesit më të lartë të fëmijëve (përfshirë fëmijët me AK) rezidentë në IPSH-të publike dhe Qendrat e Zhvillimit	44803	25413	19390	0
3.1 Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijëve rezidentë në IPSH dhe Qendrat e Zhvillimit dhe zbatimi i planeve individuale të zhvillimit për gjithë secilin fëmijë	13140	0	13140	0
3.2 Transformimi gradual i 9 IPSH-ve (institucione të shërbimeve të përkujdesjes) publike në shërbime multidisiplinare e multifunksionale për fëmijën dhe familjen), duke zbatuar interesin më të lartë të fëmijës	3891	108	3783	0





3.3 Zhvillimi i modeleve të shërbimeve për fuqizimin e familjeve për të parandaluar ndarjet e fëmijës nga familja dhe promovimin e ribashkimit familjar, si pjesë e transformimit të IPSH-ve	3573	2806	767	0
3.4 Hartimi dhe zbatimi i modelit të shërbimit për jetesë gjysmë të pavarur dhe të pavarur (për fëmijët mbi 14 vjeç, përfshirë fëmijët me AK)	8717	7277	1440	0
3.5 Fuqizimi i zbatimit të kujdesit alternativ për të gjithë fëmijët me fokus të veçantë fëmijët 0 – 6 vjeç, si pjesë e IPSH-ve që do të transformohen	15482	15222	260	0
4. Ngritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi i institucioneve dhe i publikut të gjerë për mirëqenien e fëmijëve dhe deinstitutionalizimin	9509	2904	6605	0
4.1 Ngritja e kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe private për deinstitutionalizimin në vazhdimësi	7466	2151	5315	0
4.2 Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Komunikimit për DeInstitutionalizimin	2043	753	1290	0
5. Koordinimi në nivel kombëtar dhe monitorimi i zbatimit të Planit kombëtar të Deinstitutionalizimit	4243	1505	2738	0
5.1. Koordinimi i të gjitha strukturave shtetërore për deinstitutionalizimin e fëmijëve nga IPSH-të publike (përfshirë fëmijët me AK) dhe monitorimi i planit	654	0	654	0
5.2 Monitorimi i planit të veprimit	3589	1505	2084	0
<b>TOTALI</b>	<b>65,864</b>	<b>31,888</b>	<b>33,976</b>	



TABELA 1

PLANI I VEPRIMIT NË ZBATIM TË DOKUMENTIT STRATEGJIK (2020–2022)  
I. QËLLIMI STRATEGJIK: “Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore”

II. Qëllimi i politikës: Deri në vitin 2022, çdo fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, përfshirë qendrat e zhvillimit apo në rrezik institucionalizimi, do të mbështetet me shërbime të reja alternative, në familje kujdestare apo shërbime të specializuara.

III. PROGRAMI BUXHETOR: Programi buxhetor i MSHMS-së “Përkujdesja sociale”

Nr.	Institucionet përgjegjëse	Afati i zbatimit		Lidhja me programin BUXHETOR	Kostoja indikator (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit (2020-2022)		Hondaku financiar (në mijë lekë)	Kostua indikator (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit 2020		Financim i huaj (në mijë lekë)	Hondaku financiar (në mijë lekë)	Kostua indikator (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit 2021		Financim i huaj (në mijë lekë)	Hondaku financiar (në mijë lekë)	Kostua indikator (në mijë lekë)	Burimi i mbulimit 2022		Financim i huaj (në mijë lekë)	Hondaku financiar (në mijë lekë)		
		Afati i fillimit	Afati i mbarimit			Buxhet shtetit (në mijë lekë)	Financim i huaj BB (në mijë lekë)			Buxhet shtetit (në mijë lekë)	Financim i huaj BB (në mijë lekë)				Buxhet shtetit (në mijë lekë)	Financim i huaj BB (në mijë lekë)				Buxhet shtetit (në mijë lekë)	Financim i huaj BB (në mijë lekë)				
					65,864	31,888	33,976	-	35,669	14,572	-	21,323	-	18,470	9,391	-	9,079	-	11,726	7,926	-	3,800	-		
1				Programi 0110 Planifikim, Administrim, Menaxhim	1790	407	1383	0	1790	407	0	1479	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
				Produkti 1 Akte ligjore e rindëgjyeshme të miratuaras, Pr.0110	896	311	585	0	896	311	0	585	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
				a) Analizimi i kushteve ligjore ekzistuese/evoluimit i ndryshimeve të nevojshme në legjislacion, duke përfshirë hartimin e udhëzimeve për profesionistët	180	0	180	0	180	0	0	180	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				b) Hartimi i ndryshimeve ligjore, administrative dhe procedurale, bazuar në rekomandimet e studimit	180	0	180	0	180	0	0	180	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				c) Kualiteti me masat e lehtë, agjencit shërbime dhe grupet e interesit i ndryshueshme ligjore të propozuaras	341	311	30	0	341	311	0	30	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				d) Hartimi i akteve teknologjike/medive dhe udhëzimeve nga reformën e shërbimeve shoqërore për fëmijë	195	0	195	0	195	0	0	195	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				1.2. Rregullimi i kushteve financiare të shërbimeve të reja të përkujdesjes shoqërore të modifikuara në kushte të deinstitutionalizimit	894	96	798	0	894	96	0	894	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				a) Hartimi dhe kushti i paktësimit të shërbimeve komuniste për shtet dhe familjen në bashkë	590	0	590	0	590	0	0	590	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				b) Hartimi dhe kushti i modeleve të reja të shërbimeve nga reformën e shërbimeve shoqërore për fëmijë	264	96	168	0	264	96	0	264	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				c) Hartimi dhe kushti i programit të rishikimit të fëmijëve me familjen	120	0	120	0	120	0	0	120	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				d) Hartimi i udhëzimeve për bashkëpunim të planifikuar dhe qëllimor në kuadër të Fondit Social për regjionet e shërbimeve që shtet, rishikimit e fëmijëve	120	0	120	0	120	0	0	120	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
2				Programi 0110 Përkujdesja sociale & Programi 0110	5519	1659	3860	0	4822	1424	0	3398	0	698	236	0	462	0	0	0	0	0	0		
				2.1. Monitorimi për institutionalizimin e fëmijëve	96	96	0	0	96	96	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				a) Monitorimi për institutionalizimin e fëmijëve 0-3 vjeç	48	48	0	0	48	48	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				b) Monitorimi për institutionalizimin e fëmijëve 3-6 vjeç në 2 NSHIP-të ku do të përfshihen institucionet (Korçë, Vlorë)	48	48	0	0	48	48	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				2.2. Zhvillimi i mekanizmave/institucioneve për parandalimin e institutionalizimit të fëmijëve	976	311	665	0	701	156	0	545	0	276	156	0	120	0	0	0	0	0	0	0	
				a) Hartimi i shërbimeve të kujdestare për fëmijë në bashkëpunim të shtetit me fëmijëve të vendosur aktualisht në IPSH-të publike dhe qëllimor	65	0	65	0	65	0	0	65	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				b) Zhvillimi i një koncepti shërbimeve të kujdestare për fëmijë në familje, si dhe rishikimi i zbatimit të saj në nivel kombëtar	120	0	120	0	120	0	0	120	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				c) Ngrënia e komiteteve bashkëpunuese/monitor, për parandalimin e institutionalizimit dhe ofrimi i kujdestareve, për të rishikuar shërbimet e Përkujdesjes Sociale në bashkëpunim të shtetit me fëmijëve nga familja dhe vendosjen e tyre në kushte alternative	65	0	65	0	65	0	0	65	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				d) Ndërtimi i kontakteve të shtetit, të të gjithë fëmijëve të vendosur në IPSH-të publike dhe identifikimi i drejtimeve strategjike për transformimin e IPSH-të në qendra shërbimesh përkujdesjeje alternative, duke përfshirë fëmijë të rrezikuar 0-3 vjeç	175	0	175	0	175	0	0	175	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				e) Rishikimi i kërkesave dhe procedurave të kërkuara për OPI-të që ofrojnë shërbime të kujdestareve dhe kushteve të vendit të rrezikuar të Minoritetit	551	311	240	0	276	156	0	120	0	276	156	0	120	0	0	0	0	0	0	0	0
				2.3. Ndërtimi dhe funksionimi i shërbimeve psikosociale me bazë komuniste në parandalimin e braktitjes së fëmijëve, përfshirë dhe fëmijë PAK	4447	1252	3195	0	4025	1172	0	2853	0	422	80	0	342	0	0	0	0	0	0	0	
				Shtetet Raje dhe Mësimet, Dërgimet e Vendlindjes, Akademi e tërë për OPI identifikuar																					
				Produkti 1 Akte ligjore e rindëgjyeshme të miratuaras, Pr.0110 & Pr. 0110	1172	1172	0	0	1172	1172	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				Produkti 1 Akte ligjore e rindëgjyeshme të miratuaras, Pr.0110 & Pr. 0110																					
				Produkti 1 Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofrura nëpërmjet qëllimeve të vendosura nga financimi i fondit social																					
				Produkti 1 Akte ligjore e rindëgjyeshme të miratuaras, Pr.0110 & Pr. 0110	1172	1172	0	0	1172	1172	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
				Produkti 1 Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofrura nëpërmjet																					



Table with columns for description, acronym, month, quarter, and various numerical metrics. Includes sub-sections like '3 Sigurimi i interesit në të fortë të familjeve' and '3.2 Transformimi gradual i 9 IPSH-ve'.



d) Analiza e prodhimeve, mbitimeve të sajta, për të informuar politikë vendore dhe qendrore, dhe fuqizimin e famëlidhë për produktet e ndala fëmijë.	DPZ/SHIMS	SHSSH, Pannecvë	Mars 2021	Dhjetor 2021		390	0	390	0	130	0	0	130	0	0	130	0	0	130	0	0	130	0			
<b>3.4 Hartimi dhe zbatimi i modelit të shërbimit për jetësi gjyrmë të pavarur dhe të pavarur për fëmijë në 14 vjeç për të cilin fëmijë me AK</b>	DPZ/SHIMS	SHSSH, Pannecvë	Mars 2021	Dhjetor 2022	Produkti 1 Akte ligjore e rregullime të miratuar, P.4118 & P. 4130 Produkti 3	8717	7277	1440	0	3479	2559	0	920	0	0	2879	2359	0	520	0	0	2359	2359	0	0	0
a) Mbrojtja, korrja e shërbimit të jetësi gjyrmë të pavarur dhe të pavarur (përfshirë korrë, modifikime, praktikë dhe ofrime)					Produkti 1 Akte ligjore e rregullime të miratuar, P.4118 & P.4130	520	0	520	0	260	0	0	260	0	0	260	0	0	260	0	0	0	0	0	0	0
b) Korrësimi i modelit të shërbimit me organizata të mundshme dhe bashki të mundshme (qoftë Tiranë, Shkup, Shkup)						200	200	0	0	200	200	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
c) Hartimi i programit (për mbledhjen financiare, shërbim, postime, asnjë dhe mbledhjen me ekip profesional) për të ofruar që dalin nga IPSH-të.	DPZ/SHIMS	ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Janar 2020	Qershor 2020		200	0	200	0	200	0	0	200	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
d) Ngjira dhe përbërja e shërbimit të jetësi gjyrmë të pavarur për fëmijë e imazh (14-18 vjeç)	DPZ/SHIMS	ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Shkurt 2020	Qershor 2021		200	0	200	0	200	0	0	200	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
e) Realizimi i vlerësimeve individuale për çdo fëmijë dhe familjet e tyre dhe analiza të mundshme të jetësi gjyrmë të pavarur ose të pavarur përmasë që programi mbledhësi fëmijë.	DPZ/SHIMS	ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Janar 2020	Qershor 2020	Produkti 3 P. 4130 Përfundim të shërbimeve të përkrahjes sociale të ofruara në qendrat rezidenciale publike	2514	2514	0	0	838	838	0	0	0	0	838	838	0	0	0	0	838	838	0	0	0
f) Hartimi i planeve individuale të zhvillimit dhe përkrahjes, të korrës, përfshirë modifikime të shërbimit me famëlidhë, për fëmijë dhe të ofruar të jetësi gjyrmë të pavarur dhe të pavarur.	DPZ/SHIMS	ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Qershor 2020	Dhjetor 2021	Produkti 3 P. 4130 Përfundim të shërbimeve të përkrahjes sociale të ofruara në qendrat rezidenciale publike	1860	1860	0	0	620	620	0	0	0	0	620	620	0	0	0	0	620	620	0	0	0
g) Mbledhjet, nëpërmjet monitimit të vlerësimit të planeve individuale zhvillimit dhe të përkrahjes dhe të largimit të fëmijëve në kujdes gjyrmë të pavarur dhe të pavarur për gjithë secilin fëmijë të vlerësuar	DPZ/SHIMS	ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Janar 2020	Dhjetor 2021		984	984	0	0	328	328	0	0	0	0	328	328	0	0	0	0	328	328	0	0	0
h) Vlerësimi i impaktit të kësaj modeli, dhe mundësi për të shërbyer në monitorimi e tëra.	DPZ/SHIMS	ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Mars 2020	Dhjetor 2021		260	0	260	0	0	0	0	0	0	0	260	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
i) Takime konsultive me deponitë e qendrave të zhvillimit dhe OJF-të për detyrimet e modifikimeve/kurazave në kalje me vlerësimin dhe jetësi gjyrmë të pavarur për fëmijë me afërsi të kufizuar. Ngjira e një grupi teknik të analizë të lirisë për hartimin e modifikimeve/kurazave në kalje me rastet e pavarur të fëmijëve me afërsi të kufizuar.	DPZ/SHIMS	ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Shkurt 2020	dhjetor 2021		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
j) Vlerësimi i nevojës së personalitë për të zhvilluar aftësi për të mbledhur/curuar fëmijë për jetësi të pavarur dhe jetësi gjyrmë të pavarur.	DPZ/SHIMS	ISHIP-të, Bashki, SHSSH, Pannecvë	Janar 2020	Tetor 2020		260	0	260	0	260	0	0	260	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
k) Mbledhja dhe monitimi në vlerësimin e dhe evidencës/derivimi i impaktit të jetësi gjyrmë të pavarur.	DPZ/SHIMS	Bashki, ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Mars 2020	Dhjetor 2022		1476	1476	0	0	492	492	0	0	0	0	492	492	0	0	0	0	492	492	0	0	0
l) Vlerësimi i nevojës së fëmijëve me tërë monitorimi, taktikë dhe hartimi i një plan të vlerësimit për të fokusuar jetësi gjyrmë të pavarur						243	243	0	0	81	81	0	0	0	0	81	81	0	0	0	0	81	81	0	0	0
<b>3.5 Fuqizimi i zbatimit të kujdesit alternativ për të gjithë fëmijë me fokus të veçantë (Dhjetor 6-6 vjeç, në pjesë të IPSH-të që do të transformohen)</b>	DPZ/SHIMS	SHSSH, Pannecvë	Janar 2020	Dhjetor 2022	Produkti 1 Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njëvjeç vendime nga financimi i fondit social & Produkti 3 P. 4130 Përfundim të shërbimeve të përkrahjes sociale të ofruara në qendrat rezidenciale publike	15482	15222	260	0	8832	7772	0	260	0	0	4340	4340	0	0	0	0	3110	3110	0	0	0
a) Mbledhja e 4 rënieve të qendrës vendore për të zhvilluar dhe integruar shërbime të kujdesit alternativ në planin e tyre social (planin vendore të përkrahjes shqiptare) (planifikimi e reformat, modifikime të përkrahjes, vlerësimi, monitorimi e famëlidhë, vendimet për monitorimin dhe famëlidhë, kushtet e korrësve eji, dhe përcaktuar fëmijë 0-6 vjeç.	DPZ/SHIMS	Bashki, SHSSH, Pannecvë	Qershor 2020	Qershor 2021	Produkti 1 Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njëvjeç vendime nga financimi i fondit social	2460	2460	0	0	1230	1230	0	0	0	0	1230	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
b) Mbledhja e njëvjeç të qendrës vendore për të ngjitur monitorimi e nevojatë institucionale, që do të bëjë të mundur ofrimin e shërbimeve të përkrahjes alternative (dhe në afërsi të jetësi gjyrmë të pavarur për monitorimin e IPSH-të dhe përkrahjes alternative). Ngjira e shërbimit alternativ në 4 IPSH-të (dhe pjesë të tërë të bashkisë nga UNICEF-i në përmirësimin e plotësim).	DPZ/SHIMS	Bashki, ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Janar 2020	Tetor 2020	Produkti 1 Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njëvjeç vendime nga financimi i fondit social	2460	2460	0	0	2460	2460	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
c) Hartimi i metodologjive dhe i instrumenteve për shërbime të përkrahjes alternative profesionale, në bashkëpunim me aktorët e përfshirë.	DPZ/SHIMS	Bashki, ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Janar 2020	Dhjetor 2022		260	0	260	0	260	0	0	260	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
d) Parashikimi e monitorimi të kujdesit alternativ për secilin bashki, në nevojën për t'u rikthuar, bazuar në hartin e bashkëve të origjinës të fëmijëve të vendosur aktualisht në IPSH-të.	ISHIP-të	Bashki, SHSSH, Pannecvë	Janar 2020	Dhjetor 2022	Produkti 3 P. 4130 Përfundim të shërbimeve të përkrahjes sociale të ofruara në qendrat rezidenciale publike	972	972	0	0	972	972	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
e) Vlerësimi i kujdesit alternativ të mundshëm.	Bashki	ISHIP-të, SHSSH, Pannecvë	Janar 2020	Dhjetor 2022		420	420	0	0	140	140	0	0	0	0	140	140	0	0	0	0	140	140	0	0	0





	g) Koordimim ndërinstitucional rast pas rasti sipas nevojës	MSHIMS	DPZJESHIMS, Partecak	Shtat 2020	Shtat 2020		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	h) Koordimim i punës së përbashkët për sigurinë e shërbimeve dhe shërbimeve të tjerë me bazë komunitare për fitimet me dhe pa AKR dhe përndryshe të tjerë.	DPZJESHIMS	Bashkia, SHSH, Partecak	Janar 2020	Shtat 2020		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>5.2 Monitorimi i planit të veprimit</b>	Bashkia	ESHIP-e, SHSH, Partecak	Shtat 2020	Shtat 2020	Programi 0110 Planifikim, Administrim, Menaxhim	3589	1565	2084	0	839	283	0	556	0	1375	611	0	764	0	1375	611	0	764	0	0	0
	i) Raport progresi mujor sipas sjelljes së koordinimit në nivel vendor për MSHIMS dhe sipas nevojës.	DPZJESHIMS	DPZJESHIMS, Partecak	Shtat 2020	Dhjetor 2022		858	0	858	0	234	0	0	234	0	312	0	0	312	0	312	0	0	312	0	0	0
	j) Raport progresi 6-mujor për qeverinë dhe sipas nevojës.	Bashkia	ESHIP-e, SHSH, Partecak	Shtat 2020	Dhjetor 2022		156	0	156	0	52	0	0	52	0	0	0	0	52	0	52	0	0	52	0	0	0
	ç) Hartimi i raportëve të progresit vjetor për shëndet dhe mirëmbajtje të sistemeve për rindërtim e punëqëndër social, festivalet e komunitetit, funksionimin e mekanizmit të referimit etj. dhe ndërsa me MSHIMS, SHSH.	NJKT	ESHIP-e, SHSH, Partecak	Shtat 2020	Dhjetor 2022		390	0	390	0	130	0	0	130	0	130	0	0	130	0	130	0	0	130	0	0	0
	d) Monitorimi dhe vlerësimi në vazhdim të shërbimeve të reja.	DPZJESHIMS	Bashkia, ESHIP-e, SHSH, Partecak	Shtat 2020	Dhjetor 2022		492	492	0	0	164	164	0	0	0	164	164	0	0	0	164	164	0	0	0	0	0
	e) Hartimi i kalendrit të takimeve të rregullta në gjuhë bashke për të diskutuar shëndet dhe arsimet. Dokumentimi i mësjeve dhe i praktikës.	DPZJESHIMS	Bashkia, ESHIP-e, SHSH, Partecak	Shtat 2020	Dhjetor 2022		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	f) Monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit dhe ndërtimit të shërbimit për të siguruar qëndrueshmëri dhe mundësi të replikimit në nivel kombëtar.	DPZJESHIMS	Bashkia, ESHIP-e, SHSH, Partecak	Shtat 2020	Dhjetor 2022	Programi 0110 Planifikim, Administrim, Menaxhim	916	656	260	0	0	0	0	0	0	458	328	0	130	0	458	328	0	130	0	0	0
	g) Raport-progresi vjetor i kursave të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit	DPZJESHIMS	Bashkia, ESHIP-e, SHSH, Partecak	Shtat 2020	Dhjetor 2022		777	357	420	0	259	119	0	140	0	259	119	0	140	0	259	119	0	140	0	0	0



**VENDIM**  
Nr. 711, datë 9.9.2020

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË  
100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË  
“ALBAFILM” SHA, TIRANË, NGA  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE  
EKONOMISË TE MINISTRIA E  
KULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar; të neneve 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; të nenit 9, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Albafilm” sh.a., Tiranë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Ministria e Kulturës, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shoqëria “Albafilm” sh.a., Tiranë, dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

**VENDIM**  
Nr. 712, datë 9.9.2020

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË  
BASHKISË TIRANË, TË NJËSISË  
ADMINISTRATIVE TIRANË, TË  
PASURISË 2/29, ME VENDNDODHJE  
NË ZONËN KADASTRALE 8280**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të njësisë administrative Tiranë, të pasurisë 2/29, me vendndodhje në zonën kadastrale 8280, me sipërfaqe 3343 m<sup>2</sup>, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**




## PLANVENDOSJE

BASHKIA TIRANË	A. IDENTIFIKIMI I PASURISË	
	ZONA KADASTRALE: 8280 NR. I PASURISË: 2/29 INDEKS HARTE: TR-P-12 SHKALLA: 1:500 ADRESA E PASURISË: Rrethi: Tiranë Q/F: Tiranë Rr/L: "Parku i Madh" P/G: _____ Shk: _____ K: _____ Ap: _____	VOL. 2 FQ. 88
Përgatiti: Specialisti Ing. Topograf RAIF HALIDINI  <i>Raif Halidini</i>	B. KUFIZIMET	C. PRONARI
	VERI: 2/310 JUG: 2/279 LINDJE: 2/275 PERENDIM: 2/279	SHTET
D: Data: _____	Ora: _____	

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH

 KONTURI I PASURISË SË MIRATUAR ME VKM NR. 650, DATË 31.07.2013, PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË.  
SIP. TR = 3343 M<sup>2</sup>







## UDHËZIM

Nr. 4, datë 9.9.2020

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.  
3606/2 (18), DATË 28.10.2011, “PËR  
PAJSJEN E PËRDORUESVE TË  
MJETEVE RRUGORE TË KATEGORIVE  
C, CE, D DHE DE, ME CERTIFIKATËN  
E AFTËSIMIT PROFESIONAL (CAP)”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikave 7 dhe 8, të nenit 115/1, të nenit 224, të Kodit Rrugor të Republikës Shqipërisë dhe të neneve 294 dhe 296, të vendimit nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë,

## UDHËZON:

1. Në fund të nenit 27 shtohet paragrafi, si më poshtë:

“Afati i vlefshmërisë së CAP-së, për kategorinë e drejtuesve, pa iu nënshtuar kualifikimit dhe pa testim, të cilëve iu referohet neni 25, zgjatet deri në përfundim të vlefshmërisë së kategorisë respektive të lejedrejtimit, por jo më vonë se data 20.10.2022.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
Belinda Balluku

## URDHËR

Nr. 238, datë 11.9.2020

## PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe

funksionimin e Administratës Shtetërore”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. Adrian Kamenica, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2020.

3. Urdhri me nr. 2, datë 8.1.2020, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet, Sekretari i Përgjithshëm i MTM-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
Blendi Klosi

## VENDIM

Nr. 316, datë 14.9.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR PROCEDURAT DISIPLINORE NË  
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 140, pika 1, nenin 147, pika 1, dhe nenin 147/a, pika 1, germa “b” të Kushtetutës, në nenet 100–159, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenet 61–63, nenet 66–70, nenet 72–76, nenin 97, pika 1, germa “ç” dhe pika 3, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, mbi propozimin e Komisionit Disiplinor,



## VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

## PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETAR  
**Naureda Llagami**

RREGULLORE  
PËR PROCEDURAT DISIPLINORE NË  
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregulla më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me procedura disiplinore të zhvilluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve.

Neni 2  
**Objekti**

1. Kjo rregullore përcakton:

a) kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionit Disiplinor dhe mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kryetarit, Relatorit dhe anëtarëve, si dhe detyrat e këshilltarit ligjor përgjegjës të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve dhe të personelit administrativ të Këshillit;

b) marrëdhëniet e Komisionit Disiplinor dhe të mbledhjes plenare, me këshilltarin ligjor përgjegjës të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve, personelin administrativ të Këshillit, ankuesin, gjyqtarin dhe Inspektorin e Lartë i Drejtësisë;

c) rregulla për ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe procedurale të Komisionit Disiplinor dhe mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor në paraqitjen, shqyrtimin dhe

administrimin e dokumentacionit që lidhet me procedurat disiplinore;

ç) rregulla për krijimin, trajtimin, çarkullimin, shfrytëzimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit që bëhet pjesë e dosjes së procedurës disiplinore, si dhe sigurimin e aksesit të subjekteve pjesëmarrëse në këtë dokumentacion.

Neni 3  
**Përkufizime**

Në rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ankim” është mjeti procedural i parashikuar në ligj, për kundërshtimin e veprimeve apo të mosveprimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

b) “Ditë” janë ditët kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilat llogariten me ditë pune.

c) “Fillimi i hetimit disiplinor” është fillimi i procedurës hetimore nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin për fillimin e hetimit, sipas nenit 123, të ligjit “Për statusin”.

ç) “Magjistrat” është subjekti procedural me detyrë gjyqtar, ndaj të cilit po zhvillohet një procedurë disiplinore nga Inspektori i Lartë të Drejtësisë, kryesisht apo mbi bazën e një ankese.

d) “ILD” është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve.

dh) “Këshilli” është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

e) “Komisioni” është Komisioni Disiplinor.

ë) “Këshilltari ligjor përgjegjës” është anëtar i personelit të Këshillit, i emëruar në strukturën e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve, i cili caktohet nga Kryetari i Komisionit, për të mbështetur një nga anëtarët e Komisionit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre sipas kësaj rregulloreje.

f) “Ligji për qeverisjen” është ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

g) “Ligji për statusin” është ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

gj) “Marrëveshje e përbashkët e pranimit” është marrëveshja e përbashkët, me shkrim, e nënshkruar midis magjistratit dhe ILD-së, në të cilën magjistrati pranon llojin konkret të shkeljes disiplinore dhe masën disiplinore të përshtatshme.



h) “Përfaqësues” është subjekti procedural, përfaqësues i magjistratit apo subjekte të tjera procedurale, i cili legjitimohet si i tillë, sipas parashikimeve të neneve 35–38 të Kodit të Procedurës Administrative.

i) “Raporti i hetimit” është akti me të cilin ILD-ja i jep fund hetimit disiplinor, me anë të mbylljes së hetimit ose fillimin e procedimit disiplinor me propozimin për caktimin e masës përkatëse, i hartuar sipas nenit 133 pika 3, e ligjit “Për statusin”.

j) “Relator” është çdo anëtar i Komisionit Disiplinor, i caktuar me short për një çështje, në zbatim të nenit 63, të ligjit “Për qeverisjen”, i cili kryen dhe kujdeset për zhvillimin e procedurës administrative dhe disiplinore në Komision dhe Këshill.

#### Neni 4

##### Parimet e procedurave disiplinore

1. Këshilli, në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në ligj, udhëhiqet dhe synon në zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, si dhe parimet e procedimit disiplinor, si vijon:

a) e drejta për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;

b) parimin e ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimin e “mosdënimin pa ligj”;

c) parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore;

ç) parimin e barazisë para ligjit;

d) prezumimin e pafajësisë;

dh) parimin e dyshimit në favor të subjektit të procedimit disiplinor;

e) parimin e proporcionalitetit;

ë) parimin e pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimi për pavarësinë e subjektit të proceduar;

f) parimin e drejtësisë së hapur;

g) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, së drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Këshilli dhe Komisioni duhet të marrin parasysh, veçanërisht:

a) faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e subjektit të proceduar nga akuzat e pabaza;

b) rëndësinë që ka informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.

#### Neni 5

##### Procedurat disiplinore

Procedurat disiplinore, të parashikuara në ligjin “Për statusin”, janë si vijon:

a) ankimi ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, në rastin kur nuk zbaton afatet e parashikuara nga pikat 1 deri në 4, të nenit 118 të ligjit;

b) ankimi ndaj vendimit të ILD-së, për dënimin me gjobë, sipas nenit 116 pika 4 dhe nenit 132, pika 4 e ligjit;

c) shqyrtimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimit të shkeljes disiplinore, sipas nenit 135 të ligjit, si dhe të ankimit ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, sipas pikës 9 të këtij neni;

ç) shqyrtimi e procedimeve disiplinore, të filluara nga ILD-ja, sipas neneve 138–147 të ligjit, dhe kur është rasti, marrjen e masave disiplinore të parashikuara në ligj;

d) marrja e të gjitha masave të nevojshme dhe sigurimin e zbatimit dhe mbikëqyrjen e masave disiplinore, që vendosen në përfundim të një procedimi disiplinor;

dh) pezullimi i detyruar të magjistratit nga detyra, në bazë të nenit 151 të ligjit;

e) pezullimi i magjistratit, ndaj të cilit është paraqitur një kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, sipas nenit 138, kryesisht apo mbi kërkesën e ILD-së.

#### Neni 6

##### Konflikti i interesit

1. Anëtari i Këshillit, i pranishëm, përkatësisht, në mbledhjen e Këshillit ose të Komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, për veten ose për një anëtar tjetër,



lidhur me një çështje të rendit të ditës, në përputhje me nenin 72, 73, 74, 75, të ligjit “Për qeverisjen”, është i detyruar për sa më poshtë:

- a) të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës;
- b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse;
- c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.

2. Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare ose Komisionit, në rastin, kur:

- a) anëtari ka paraqitur tek ILD-ja kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor;
- b) si anëtar i Komisionit, ka marrë vendim për një çështje disiplinore, të parashikuar në pikën 13, të nenit 62, të ligjit “Për qeverisjen”.

3. Çdo anëtar i Këshillit, menjëherë pas marrjes së rendit të ditës dhe materialeve për një mbledhje të ardhshme të Këshillit ose të Komisionit, dhe në çdo rast para votimit të çështjes përkatëse, deklaron konfliktin e interesit ose pengesën ligjore, sipas neneve 73 dhe 74, të ligjit “Për qeverisjen”. Anëtari i Këshillit i cili ka deklaruar konfliktin e interesit ose pengesën nuk merr pjesë në diskutimin ose votimin e çështjes përkatëse në Komision dhe në Këshill.

4. Nëse rastet e konfliktit të interesit, sipas nenit 75, të ligjit “Për qeverisjen”, anëtari kërkon heqjen dorë nga diskutimi ose votimi. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit, merret nga Kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep Kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.

5. Nëse një anëtar ka dijeni se një anëtar tjetër i Këshillit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose pengesës ligjore, sipas neneve 73, 74 apo 75, të ligjit “Për qeverisjen”, e deklaron atë menjëherë pas marrjes dijeni, dhe në çdo rast para votimit të çështjes përkatëse.

6. Anëtari për të cilin pretendohet konflikti i interesit ose pengesa ligjore deklaron qëndrimin e tij në lidhje me këtë pretendim. Nëse anëtari vlerëson se pretendimi qëndron, sipas rastit, ai nuk merr pjesë në diskutimin apo votimin e çështjes përkatëse ose kërkon heqjen dorë. Kur kërkesa për heqje dorë bëhet në mbledhje plenare ose në mbledhje të Komisionit, diskutimi ose votimi i çështjes në fjalë mund të shtyhet për në mbledhjen e radhës.

7. Gjyqtari i proceduar ose përfaqësuesi ligjor i tij ose ILD-ja mund të kërkojnë përjashtimin e

anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative vetëm në fazën paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75, të ligjit “Për qeverisjen”, dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes. Vendimi për përjashtimin e një anëtarit, nga shqyrtimi i një çështjeje në mbledhje plenare ose në Komision, merret nga Këshilli në mbledhje plenare, sipas rregullave të parashikuara në nenin 72, të ligjit “Për qeverisjen”. Kur kërkohet përjashtimi i Kryetarit të Këshillit, mbledhja plenare kryesohet nga zëvendëskryetari i Këshillit.

## KREU II

### ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

#### SEKSIONI I

#### ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT DISIPLINOR

##### Neni 7

#### **Komisioni Disiplinor**

1. Komisioni Disiplinor organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, pa afat të caktuar.

2. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë dhe dy anëtarë zëvendësues. Anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit zgjidhen nga Këshilli. Anëtarët e përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit shërbejnë për një mandat dy vite e gjysmë nga data e zgjedhjes së tyre.

##### Neni 8

#### **Kuorumi dhe mbledhja e Komisionit**

1. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme vetëm kur në të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Komisioni mblidhet, në ditën, orën dhe vendin e caktuar nga Kryetari. Komisioni mblidhet edhe me propozim të një anëtarit.

2. Kryetari i Komisionit cakton rendin e ditës për mbledhjen, pas konsultimit me anëtarët. Para mbledhjes, çdo anëtar i Komisionit mund të kërkojë shtimin e çështjeve të tjera në rendin e ditës. Ato përfshihen nëse votojnë, pro kërkesës, jo më pak se dy anëtarë.



3. Mbledhjet e Komisionit drejtohen nga Kryetari. Çdo anëtar i Këshillit mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Komisionit.

4. Komisioni ka të drejtë të kërkojë çdo dokumentacion, i cili konsiderohet i nevojshëm dhe ndihmës për veprimtarinë e tij sipas ligjit.

5. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të dëgjohet për mendimin e tij në lidhje me çështjen që diskutohet. Vendimet në Komision merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve.

6. Rregullat e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit janë të njëjta me ato të zhvillimit të mbledhjes plenare të Këshillit, për aq sa ato janë të zbatueshme. Rregullat për pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen në distancë në Këshill, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për Komisionin.

#### Neni 9

##### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit**

1. Kryetari i Këshillit është Kryetar i Komisioni, në rastin kur është një nga anëtarët e tij. Në rastet e tjera, Kryetari i Komisionit zgjidhet në mbledhjen e parë të Komisionit, me propozim të Kryetarit të Këshillit.

2. Kryetari i Komisionit është përgjegjës, për:

- a) funksionimin e duhur të Komisionit;
- b) mbikëqyrjen e punës dhe administrimin e Komisionit;
- c) përgatitjen për mbledhjen;
- ç) shpërndarjen e të gjitha materialeve të mbledhjes, në kohën e duhur, për anëtarët e Komisionit;
- d) caktimin e orës, datës dhe vendit të mbledhjes;
- dh) caktimin e rendit të ditës dhe kryesimin e mbledhjeve të Komisionit;
- e) ndarjen e barabartë dhe të drejtë të detyrave, duke marrë në konsideratë angazhimin profesional të anëtarëve të Komisionit;
- ë) caktimin e këshilltarit ligjor përgjegjës, për të asistuar anëtarin në përmbushjen e detyrave të tij;
- f) raportimin në Këshill për punën e realizuar nga Komisioni.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit janë:

- a) të marrin pjesë, të respektojnë dhe zbatojnë procedurat për mbledhjet e Komisionit;

- b) të realizojnë brenda afateve kohore detyrat e caktuara nga Komisioni dhe Këshilli;

- c) të informojnë sa më herët të jetë e mundur Kryetarin, kur nuk mund të marrin pjesë në mbledhjen e Komisionit;

- ç) të mos nxjerrin asnjë informacion sensitiv nga mbledhjet me detyrë të mbyllura të Komisionit;

- d) të shmangin favorizimin, anshmërinë ose diskriminimin mbi çfarëdo baze, kur shqyrtojnë çështje, marrin vendime ose votojnë për çështje që i paraqiten Komisionit;

- dh) të përdorin ekskluzivisht adresën e postës zyrtare të Këshillit për të gjitha komunikimet e brendshme dhe të jashtme që lidhen me punën dhe aktivitetet e Komisionit dhe të Këshillit.

#### Neni 10

##### **Zëvendësimi i anëtarit të Komisionit**

1. Në rastin kur një nga anëtarët e Komisionit heq dorë nga pjesëmarrja në mbledhje të Komisionit ose përjashtohet, për shkak të konfliktit të interesit, pengese tjetër ligjore, si dhe kur ai mungon në detyrë, për shkak të rasteve të tjera të pamundësisë së përkohshme, në shqyrtimin çështjes futet anëtari zëvendësues.

2. Anëtari zëvendësues shërben si anëtar aktiv i Komisionit, sa herë që një anëtar i përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për arsye objektive ose pengese ligjore. Anëtarët jogjyqtarë mund të zëvendësojnë vetëm anëtarët jogjyqtarë dhe anëtarët gjyqtarë mund të zëvendësojnë vetëm anëtarët gjyqtarë të Komisionit.

3. Kohëzgjatja e zëvendësimit varet nga natyra e arsyes dhe rrethanave për të cilat është bërë zëvendësimi:

- a) nëse anëtari i përhershëm që zëvendësohet, ka pengesë ligjore në trajtimin e një çështje konkrete, anëtari zëvendësues merr pjesë për kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes.

- b) nëse gjendja e padisponueshmërisë së anëtarit të rregullt zgjat më shumë se 5 ditë, anëtari zëvendësohet dhe zëvendësuesi shërben deri në përfundim të kësaj gjendje.

4. Nëse një anëtar zëvendësues i Komisionit zëvendëson Kryetarin e Komisionit, kryetari i ri zgjidhet me short ndërmjet anëtarëve të përhershëm të Komisionit. Kryetari i ri ushtron këtë funksion për sa kohë zgjat gjendja e zëvendësimit të anëtarit të përhershëm. Nëse një



anëtar zëvendësues i Komisionit zëvendëson një anëtar të Komisionit, i cili shërbente si relator, zgjidhet një relator i ri me short. Në çdo rast, nëse anëtarë zëvendësues shërben si relator, ai ushtron funksionin e anëtarit zëvendësues deri në përfundim të çështjes për të cilën ai është caktuar si relator.

## SEKSIONI II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE MBËSHTETËSE TË KOMISIONIT

### Neni 11

#### Njësia Mbështetëse e Komisioneve

1. Komisioni asistohet në veprimtarinë e tij nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve, e cila përbën strukturën ndihmëse dhe këshillimore, që mbështet punën profesionale të anëtarëve të Komisionit.

2. Njësia Mbështetëse e Komisioneve ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës, duke përfshirë:

- a) përgatitjen e çështjes për shqyrtim;
- b) kryerjen e kërkimeve shkencore;
- c) dhënien e opinioneve ligjore.

3. Kryetari i Komisionit cakton një Këshilltar Ligjor përgjegjës, nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve, për secilin nga anëtarët e Komisionit.

4. Këshilltari Ligjor përgjegjës, gjatë shqyrtimit të një çështjeje në Komision, ka kryesisht detyrat e mëposhtme:

a) jep mendimin e tij Relatorit të çështjes, pranë të cilit është caktuar, në lidhje me mënyrën se si do të procedohet me shqyrtimin e saj dhe veprimet procedurale që duhet të kryhen nga Relatori dhe Komisioni, me qëllim përgatitjen sa më të shpejtë të çështjes për në Këshill;

b) përgatit projektaktet dhe relacionin paraprak, duke dhënë mendimin e tij si mbi pranueshmërinë dhe mbi zgjidhjen në themel të çështjes;

c) kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga Relatori i çështjes ose Komisioni.

5. Këshilltari Ligjor përgjegjës, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore në lidhje me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Komisionit gjatë shqyrtimit të kësaj

çështjeje. Në këtë rast zbatohen dispozitat e rregullores së Këshillit “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor”. Kërkesa për dorëheqje i drejtohet Kryetarit të Komisionit, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe këshilltarin ligjor përgjegjës zëvendësues nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve.

### Neni 12

#### Personeli administrativ i Këshillit

1. Komisioni mbështetet në veprimtarinë e tij nga anëtarët e personelit administrativ të Këshillit, të cilët ushtrojnë veprimtari ndihmëse, duke përmbytur këto detyra, por pa u kufizuar në to:

a) regjistrimin e të dhënave në regjistrat e posaçëm, në lidhje me çështjet e paraqitura për shqyrtim në Këshill dhe, në veçanti:

i. identifikon natyrën e çështjes;

ii. regjistron dhe numëron atë në regjistrin përkatës;

iii. krijon dosjen e çështjes.

b) përcjelljen e çështjes Kryetarit të Këshillit për të vijuar sa më shpejt të jetë e mundur, me procedurat për hedhjen e shortit;

c) dorëzimin e dosjes së çështjes te Relatori dhe bashkëpunon me Këshilltarin Ligjor përgjegjës, për mbarëvajtjen e të gjithë procedurës;

ç) mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve të Komisionit;

d) mbajtjen e të gjitha komunikimet e vazhdueshme të njoftimeve dhe të akteve shkresore, me subjektet ankuese/kërkuese ose me përfaqësuesit e tyre, gjatë shqyrtimit të çështjes, mbi bazën e urdhërimeve të Komisionit ose të Këshillit;

dh) redaktimin e akteve të Komisionit në këndvështrimin gjuhësor;

e) numërtimin e vendimit pas përfundimit të plotë të shqyrtimit të çështjes dhe dhënies së vendimit;

ë) marrjen e masave për njoftimin e akteve sipas urdhërimeve të Relatorit;

f) marrjen në dorëzim të dosjes nga Relatori në përfundim të procedurës dhe depozitimin e saj për arkivim;

g) ndjek procedurën e ankimit ndaj vendimit të Këshillit, mbi ankimin e palëve në procedurë,



përveç kur me vendim të Këshillit vendoset ndryshe;

gj) vënie në dispozicion strukturave të Këshillit dhe Komisionit të çdo lloj informacioni, dokumentacioni dhe statistike sipas kërkesës së tyre, për qëllime të procedurës.

2. Me fillimin e procedurës, sipas kësaj rregulloreje, Sekretari i Përgjithshëm cakton personelin administrativ përgjegjës për kryerjen e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Personeli administrativ i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore, në lidhje me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Komisionit gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje. Në këtë rast zbatohen dispozitat e rregullores së Këshillit “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor”. Kërkesa për dorëheqje i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe personelin administrativ zëvendësues nga anëtarët e personelit të Këshillit.

### SEKSIONI III

#### VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

##### Neni 13

#### Depozitimi për shqyrtim

1. Në Këshill depozitohen për shqyrtim administrativ sipas kësaj rregulloreje:

a) ankimi i magjistratit ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, në rastin kur nuk zbaton afatet e parashikuara nga pikat 1 deri në 4, të nenit 118 të ligjit “Për statusin”;

b) ankimi ndaj vendimit të ILD-së për dënimin me gjobë;

c) marrëveshja e përbashkët e magjistratit dhe ILD-së, për pranimin e shkeljes disiplinore;

ç) ankimi ndaj mosveprimit administrativ të ILD-së, sipas nenit 135, pika 9, e ligjit “Për statusin”;

d) kërkesa e ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor, së bashku me raportin hetimor dhe dosjen përkatëse;

dh) kërkesa e ILD-së për pezullimin e magjistratit nga detyra, si dhe kërkesat e palëve për ndryshimin ose revokimin e pezullimit të vendosur.

2. Data e marrjes në Këshill, të akteve të parashikuara në pikën 1, në regjistrin përkatës, është:

a) data e depozitimit në Këshill, në rastin kur akti paraqitet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur, nga subjekti përkatës;

b) data e depozitimit në Këshill nga shërbimi postar, në rastin kur akti është dërguar nëpërmjet shërbimit postar;

c) data e mbërritjes në adresën elektronike zyrtare të Këshillit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për komunikimin dhe dokumentin elektronik.

##### Neni 14

#### Regjistri i posaçëm

1. Pranë Këshillit, krijohet dhe administrohet një regjister i posaçëm, në të cilin regjistrohen:

a) çështjet në lidhje me ankimet e paraqitura në Këshill nga subjektet e përcaktuara në ligj dhe sipas kësaj rregulloreje;

b) kërkesat për pezullimin e magjistratit nga ushtrimin i detyrës gjatë një procedure disiplinore, si dhe ato për ndryshimin apo revokimin e pezullimit;

c) çështjet në lidhje me procedimet disiplinore, si dhe vendimet e formës së prerë të marra në këto procedime.

2. Nëse është e nevojshme, Këshilli, për nevoja të punës, mund të miratojë edhe regjistra të tjerë, duke përcaktuar llojin e të dhënave që do të hidhen në secilin prej tyre.

3. Regjistrimi dhe gjithë procesi i menaxhimit të çështjeve, dokumentohet në regjistra manualë që mbahen në Këshill, si dhe në çdo formë tjetër që përcaktohet në të ardhmen për këtë qëllim.

##### Neni 15

#### Formimi i dosjes

Për çdo çështje, të regjistruar për shqyrtim sipas nenit 13 të kësaj Rregulloreje, formohet një dosje e veçantë, në të cilën administrohet dhe numërtohet, i gjithë dokumentacioni, i krijuar dhe i mbledhur gjatë procedurës së shqyrtimit të kësaj çështjeje në Komision, si dhe në Këshill.



## Neni 16

**Procedura e shortit**

1. Procedura e shortit realizohet duke u bazuar në parimet e transparencës, objektivitetit dhe në shpërndarjen rastësore dhe të barabartë të ngarkesës së punës midis anëtarëve të Komisionit.

2. Bazuar në arsye që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi bazën e kërkesës së motivuar të Kryetarit ose të çdo anëtari të Komisionit, mbledhja plenare e Këshillit gjatë procedurës së hedhjes së një shorti, mund të vendosë:

a) përjashtimin e një anëtari nga shorti;

b) përfshirjen në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit, dhe të anëtarëve zëvendësues. Në këtë rast, Komisioni përbëhet nga Kryetari dhe një anëtar i përhershëm, nga radhët e gjyqtarëve ose jogjyqtarëve, në varësi të radhëve nga vjen anëtari zëvendësues, i caktuar si relator;

c) rregulla të tjera për mënyrën e hedhjes së shortit, në varësi të rrethanave dhe në funksion të rritjes së efektivitetit dhe transparencës.

3. Në çdo rast, në procedurën e shortit për caktimin e relatorit të çështjes, nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë.

4. Shorti hidhet midis anëtarëve të Komisionit, duke u bazuar në forma elektronike për caktimin e relatorit. Deri në përcaktimin dhe vendosjen e tyre, shorti hidhet manualisht, sipas procedurës së vendosur në Këshill.

## Neni 17

**Kalimi i çështjes te Relatori**

Pas përfundimit të procedurës së shortit, personeli administrativ kompetent i dorëzon menjëherë Relatorit, dosjen e regjistruar, e cila përmban kryesisht:

a) në rastin e ankimeve dhe kërkesave për pezullim, ankimin/kërkesën, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues të depozituar nga subjektet;

b) në rastin e procedurave për pezullimin për shkak të ligjit, informacionin e njoftuar, sipas neneve 127, 151 dhe 154 të ligjit “Për Statusin”;

c) në rastin e procedimeve disiplinore, kërkesën për procedim disiplinor, raportin e hetimit, marrëveshjen, dosjen personale, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues, të depozituar nga ILD-ja.

Faqe | 12042

## Neni 18

**Radha e shqyrtimit**

Radha e shqyrtimit të çështjeve përcaktohet duke pasur në konsideratë përparësitë e procedimeve disiplinore dhe kërkesave me natyrë urgjente, si edhe datën e depozitimit të çështjes në Këshill.

## Neni 19

**Veprimet paraprake të Relatorit dhe Komisionit në përgatitjen e çështjes**

1. Relatori përgatit çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Komisionit, si dhe në mbledhjen plenare të Këshillit.

2. Relatori, me mbështetjen e Këshilltarit përgjegjës dhe personelit administrativ të caktuar, kryen dhe kujdeset për detyrat si më poshtë, por pa u kufizuar në to:

a) përgatit projektaktin dhe relacionin mbi çështjen;

b) kryen të gjitha procedurat për të siguruar administrimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe të informacionit shtesë për procesin e vendimmarrjes së Komisionit dhe mbledhjes plenare të Këshillit;

c) merr masat për të hartuar të gjitha aktet procedurale, deri në përfundimin e çështjes;

ç) koordinon me Kryetarin e Këshillit ose Komisionit për përgatitjen, respektivisht, të mbledhjes së Këshillit ose Komisionit;

d) njofton subjektet e procedimit administrativ.

3. Këshilltari përgjegjës, pas studimit të çështjes përgatit një relacion paraprak, nën kujdesin e Relatorit të çështjes, dhe e shpërndan atë tek anëtarët e Komisionit. Nëse anëtarët e Komisionit kanë pyetje apo kërkesa për shpjegime në lidhje me të, ia dërgojnë ato Relatorit dhe Këshilltarit përgjegjës.

4. Pas mbylljes së veprimeve përgatitore, Kryetari i Komisionit, me kërkesë të Relatorit dhe në koordinim me anëtarin tjetër, cakton datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes.

5. Komisioni, pas shqyrtimit të çështjes dhe relacionit, verifikon procedurën e ndjekur dhe kur e konsideron të rregullt vendos kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhje plenare.





Neni 20

**Mënyrat e njoftimit të akteve**

1. Aktet e procedurës, sipas kësaj rregulloreje, u njoftohen palëve në një ose disa nga format e mëposhtme:

- a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;
- b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës të marrësit;
- c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga subjekti i aktit administrativ.

2. Vendimi i Këshillit bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.

Neni 21

**Arkivimi i praktikës dokumentare**

Praktika dokumentare arkivohet në Zyrën e Protokoll-Arkivit të Këshillit, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi arkivat.

## KREU III

## PROCEDURA TË VEÇANTA

## SEKSIONI I

## SHQYRTIMI ADMINISTRATIV I ANKIMEVE

Neni 22

**Paraqitja e ankimit**

1. Ankimi paraqitet nga pala ankuese ose nga përfaqësuesi i zgjedhur prej saj. Përfaqësuesi legjitimohet si i tillë dhe kryen disa ose të gjitha veprimet procedurale, sipas parashikimeve të nenit 38 të Kodit të Procedurës Administrative.

2. Çdo akt drejtuar Këshillit vlerësohet si ankim edhe nëse nuk është emërtuar shprehimisht si i tillë, por del nga përmbajtja e këtij akti dhe është mjaftueshëm i qartë. Ankimi paraqitet në formë të shkruar, në gjuhën shqipe, qartë dhe kuptueshëm, si dhe duhet të përmbajë:

- a) emrin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndaj të cilit drejtohet ankimi;

b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e ankuesit dhe/ose të përfaqësuesit të tij, në rastin e personave fizikë;

c) emërtimin e personit juridik ankues, përfaqësuesin e tij ligjor, vendbanimin ose vendqëndrimin dhe/ose përfaqësuesin e zgjedhur;

ç) vendimin e ILD-së kundër të cilit paraqitet ankimi ose mosveprimin administrativ të ILD-së;

ç) parashtrimin e objektit dhe shkaqeve të ankimit;

d) aktet procedurale, të cilat i bashkëlidhen ankimit, të tilla si:

i) akti i përfaqësimit, në rast se ankimi paraqitet nga përfaqësuesi i zgjedhur i ankuesit;

ii) kopje të vendimit të ILD-së objekt ankimi;

iii) dokumente, prova, apo materiale të tjera që shoqërojnë ankimin, në origjinal ose të njësuara me origjinalin.

dh) nënshkrimin e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij, në rast se ankimi paraqitet prej këtij të fundit, sipas tagrave të dhëna shprehimisht në aktin e përfaqësimit.

Neni 23

**Verifikimi i ankimit**

1. Relatori verifikon nëse ankimi plotëson kriteret formale të parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Ankimi që nuk plotëson këto kriterë konsiderohet i metë. Relatori njofton ankuesin, me shkrim, duke i caktuar një afat 10 ditë për plotësimin e të metave të konstatuara. Në rast se ankuesi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, Komisioni vendos mospranimin e ankimit.

2. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99, të ligjit “Për qeverisjen”.

Neni 24

**Shqyrtimi paraprak i ankimit**

1. Pas verifikimit të kriterëve formale të ankimit, Relatori verifikon kushtet e pranueshmërisë së tij për shqyrtim. Ankimi është i pranueshëm për shqyrtim, nëse plotëson këto kushte:

a) është bërë kundër një vendimi apo mosveprimi administrativ të ILD-së;

b) ankuesi ka legjitimitet sipas parashikimeve të ligjit “Për statusin”;



c) është paraqitur brenda afateve të parashikuara në ligj.

2. Për ankimin që nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioni vendos mospranimin e ankimit. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99, të ligjit “Për qeverisjen”.

Neni 25

#### **Pushimi i shqyrtimit të ankimit**

1. Ankuesi mund të heqë dorë nga ankimi derisa Komisioni nuk ka marrë një vendim në lidhje me të. Në këtë rast, Komisioni vendos pushimin e ankimit.

2. Komisioni vendos në të njëjtën mënyrë edhe në rastin kur objekti për të cilin kishte nisur shqyrtimi i ankimit apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

3. Ankuesi ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99, të ligjit “Për qeverisjen”.

Neni 26

#### **Shqyrtimi në themel i ankimit**

1. Pas verifikimit të plotësisë të kushteve të pranueshmërisë, Relatori përgatit relacionin dhe projekt-aktin për shqyrtimin në themel të ankimit. Komisioni mund të vendosë pranimin ose rrëzimin e ankimit.

2. Kundër vendimit të rrëzimit ankuesi ka të drejtë të kërkojë ndryshimin nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99 të ligjit “Për qeverisjen”.

3. Në rastin e ankimit, sipas nenit 132, pika 4, të ligjit “Për statusin”, Relatori kërkon menjëherë nga ILD-ja dhe një kopje të akteve që kanë shërbyer për marrjen e vendimit.

4. Në rastin e ankimit ndaj mosveprimit administrativ, Relatori kërkon që menjëherë ILD-ja të paraqesë pa vonesë një kopje të dosjes së çështjes dhe arsyet e mosveprimit administrativ.

## **SEKSIONI II**

### **SHQYRTIMI ADMINISTRATIV I KËRKESËS PËR PEZULLIMIN NGA DETYRA TË MAGJISTRATIT**

Neni 27

#### **Paraqitja e kërkesës**

1. Kërkesa për pezullimin e magjistratit nga detyra paraqitet në Këshill nga ILD-ja ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni mbështetës shtesë, nëse ka, mbi të cilin është mbështetur vendimmarrja e ILD-së, sipas nenit 152, pika 1, të ligjit “Për statusin”.

2. Pas regjistrimit, kërkesa i nënshtrohet menjëherë procedurës së shortit në caktimin e Relatorit të çështjes, nëse paraqitet njëkohësisht me kërkesën për procedim disiplinor. Nëse procedimi disiplinor ka filluar, kërkesa i kalon menjëherë për shqyrtim Relatorit të çështjes.

Neni 28

#### **Shqyrtimi i kërkesës**

1. Relatori, brenda 24 orëve nga caktimi i tij apo paraqitja e kërkesës, i propozon mbledhjes plenare të Këshillit:

a) rrëzimin e kërkesës;

b) pranimin e kërkesës dhe pezullimin e magjistratit nga detyra.

2. Këshilli merr vendim në lidhje me kërkesën brenda 3 ditëve nga paraqitja e saj.

3. Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e pezullimit kryesisht të magjistratit nga detyra, sipas neneve 151 dhe 152, të ligjit “Për STATUSIN”. Në këtë rast afatet llogariten nga dita e marrjes së informacionit nga ILD-ja apo prokuroria ose gjykata përkatëse ose nga konstatimi i rrethanave të parashikuara në nenin 152, të ligjit “Për statusin”.

4. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në Gjykatën e Apelit Administrativ. Paraqitja e ankimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.



Neni 29

**Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesave në lidhje me kohëzgjatjen dhe revokimin e pezullimit**

1. Kërkesa për ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit apo revokimin e pezullimit paraqitet në Këshill nga ILD-ja apo magjistrati. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni mbështetës shtesë, nëse ka, i cili duhet të provojë që pezullimi nuk mund të vazhdojë, për shkak se arsytet e vendosjes së pezullimit, të parashikuara në nenet 151 dhe 152, të ligjit “Për statusin”, kanë pushuar së ekzistuari.

2. Pas regjistrimit, kërkesa i kalon menjëherë për shqyrtim Relatorit të çështjes.

3. Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e ndryshimit të kohëzgjatjes së pezullimit apo revokimit të pezullimit, kryesisht, sipas nenit 156, të ligjit “Për statusin”.

4. Komisioni i propozon mbledhjes plenare, sipas rastit:

- a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;
- b) revokimin e pezullimit; ose
- c) lënien në fuqi të pezullimit.

**SEKSIONI III  
PROCEDIMI DISIPLINOR**

Neni 30

**Paraqitja e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor**

1. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor depozitohet në Këshill nga ILD-ja ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij. Bashkë me kërkesën depozitohet raporti i hetimit dhe dosja përkatëse, sipas nenit 133, të ligjit “Për statusin”.

2. Pas regjistrimit, kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor i nënshtrohet procedurës së shortit në caktimin e Relatorit të çështjes. Në rastin kur kërkesa përmban kërkimin për pezullimin e magjistratit nga detyra, procedura e shortit në caktimin e Relatorit të çështjes zhvillohet menjëherë.

3. Relatori verifikon nëse kërkesa plotëson kriteret formale të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Kërkesa që nuk plotëson këto kriteret konsiderohet e metë. Relatori njofton ILD-në, me shkrim, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për plotësimin e të metave të konstatuara. Në

rast se ILD-ja nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, Komisioni mund të vendosë kthimin e kërkesës bashkë me aktet e depozituara.

4. ILD-ja ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99, të ligjit “Për qeverisjen”.

Neni 31

**Shqyrtimi paraprak i çështjes**

1. Relatori, pas verifikimit të kriterëve formale, mund t'i propozojë mbledhjes plenare të Këshillit:

a) mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, sipas nenit 139, të ligjit “Për statusin” ose;

b) përcaktimin e seancës dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda një muaji nga dita e marrjes së dosjes nga ILD-ja. Afati për caktimin e seancës dëgjimore mund të zgjatet deri në dy muaj, për shkaqe të rëndësishme, të cilat bëhen publike.

2. Në rastin e vendimit për caktimin e seancës dëgjimore, Këshilli duhet të mbajë në vlerësim:

a) njoftimin e palëve në procedurë për datën e seancës, të paktën 15 ditë para saj; si dhe

b) afatin brenda të cilit magjistrati duhet të paraqesë parashtrësat me shkrim, sipas nenit 141, pika 2, germa “a”, të ligjit “Për statusin”.

3. Këshilli mbyll procedimin disiplinor sipas pikës 1, germa “a”, të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban dhe shkaqet e mbylljes së procedimit.

4. Vendimet sipas këtij neni u njoftohen palëve në procedurë, brenda 5 ditëve, nga marrja e tyre.

Neni 32

**Të drejtat e magjistratit pas vendimit të caktimit të seancës dëgjimore**

1. Relatori, me njoftimin e vendimit të Këshillit për caktimin e seancës dëgjimore, i bën të ditur magjistratit të drejtat, si vijon:

a) për t'u njohur me dokumentet e dosjes dhe për të marrë kopje të tyre, brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës së tij;

b) për të paraqitur një parashtrësë me shkrim brenda një afati të caktuar;

c) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;

ç) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;

d) për të paraqitur dokumente;



dh) për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;

e) për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Administrative;

ë) për të kërkuar përjashtimin e Relatorit, të një ose disa anëtarëve të Këshillit, nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës disiplinore, vetëm gjatë fazës paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e nenit 75, të ligjit “Për qeverisjen” dhe anëtari nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes;

f) për kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme ligjore, në raste kur nuk vendoset masë disiplinore.

2. Komisioni mund të vendosë kufizimin e së drejtës së aksesit me dosjen, vetëm në rastet dhe mënyrën e parashikuar në nenin 141, pika 1/1, të ligjit “Për statusin”. Magjistrati ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e këtij vendimi nga mbledhja plenare e Këshillit, sipas nenit 99, të ligjit “Për qeverisjen”.

#### Neni 33

#### Veprimet paraprake

1. Veprimet paraprake janë të gjitha ato veprime procedurale, të cilat kanë si qëllim përgatitjen e çështjes për seancë dëgjimore. Ato kryhen nga ana e Komisionit, me anë të Relatorit të çështjes.

2. Komisioni dhe Relatori, në këtë fazë të procedurës, kujdeset për kryerjen e detyrave që lidhen me:

a) shqyrtimin e të gjithë faktorëve që kanë rëndësi për çështjen dhe të dokumentacionit të depozituar nga subjektet procedurale;

b) njoftimin e magjistratit të proceduar se ndaj tij ka filluar një procedim disiplinor, si dhe njoftimin e të drejtave të tij sipas nenit 32 të rregullores;

c) njoftimin e subjekteve procedurale për vendimin e caktimit të seancës dëgjimore dhe afatin brenda të cilit magjistrati i proceduar duhet të paraqesë parashtrimit me shkrim;

ç) marrjen e vendimeve nga mbledhja plenare e Këshillit, për:

i. pranueshmërinë e provave;

ii. thirrjen, angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, kur e konsideron të përshtatshme ose kërkon nga ILD-ja thirrjen e ekspertëve;

iii. marrjen e provave shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve;

iv. kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga ILD-ja, duke specifikuar elementet që mungojnë dhe afatin;

v. paraqitjen nga ana e magjistratit të të dhënave, dokumenteve ose çdo lloj prove si marrjen pjesë të tij në seance dëgjimore në trajtimin e çështjes;

vi. bashkimin e procedimeve, sipas nenit 140, të ligjit “Për statusin”;

vii. ndryshimin ose shtimin e objektit të procedimit disiplinor, sipas nenit 144, të ligjit “Për statusin”;

viii. pezullimin e procedimit disiplinor, sipas neneve 145 dhe 126, të ligjit “Për statusin”;

d) kryerjen e çdo veprimi tjetër që vlerësohet i nevojshëm ose i përshtatshëm;

dh) si dhe përgatitjen e relacionit paraprak mbi çështjen, i cili duhet t'iu vihet në dispozicion anëtarëve të Këshillit, para seancës dëgjimore. Ky relacion, përmban në mënyrë të përmbledhur:

i. të dhënat e subjekteve procedurale;

ii. objektin e kërkesës;

iii. parashtrimin e pretenduar të fakteve dhe rrethanave;

iv. pretendimet e organit procedues dhe parashikimet ligjore, mbi të cilat bazohet kërkimi;

v. parashtrimet e subjektit të proceduar; si dhe

v. çdo propozim të Komisionit, për marrjen e vendimeve sipas pikës 2, germat “ç” dhe “d” të këtij neni.

#### Neni 34

#### Publiciteti i seancës

1. Seanca dëgjimore është publike.

2. Prania e shtypit të shkruar dhe elektronik në sallë, gjatë seancës dëgjimore publike, është e lejuar, për sa kohë nuk pengon zhvillimin normal të seancës. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi gjatë seancës, si rregull, nuk lejohet. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi realizohen sipas rregullave të hollësishme të marrëdhënieve me median, të miratuara me rregullore të posaçme të Këshillit.

3. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet:

a) kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të



dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;

b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magistratit ose një personi tjetër;

c) kur nga publiku ka shfaqje që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.

4. Kur Këshilli zhvillon mbledhje me dyer të mbyllura, publiku dhe media largohen nga salla e mbledhjeve. Në çdo rast votimi është i hapur dhe publik.

#### Neni 35

##### Solemniteti i seancës

1. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore respektohen rregullat e solemnitetit, të cilat janë:

a) respektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e seancës nga pjesëmarrësit;

b) respektimi i rendit dhe i qetësisë gjatë zhvillimit të seancës;

c) respektimi nga palët i kërkesave për të parashtruar në bazë të fakteve të pretenduara shpjegimet e nevojshme e të dobishme për shqyrtimin e çështjes;

ç) respektimi i anëtarëve të Këshillit dhe të të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në gjykim;

d) mbajtja e togës së posaçme nga avokatët dhe veshjes serioze dhe të përshtatshme nga pjesëmarrësit e tjerë në sallë.

2. Në rast se palët në seancë nuk respektojnë rregullat e solemnitetit, Kryetari i Këshillit merr masat për zhvillimin e duhur të seancës. Nëse është e nevojshme, ndërpret diskutimin ose u heq palëve të drejtën e fjalës, ose mund të urdhërojë largimin e personave nga salla.

3. Për sigurimin e solemnitetit dhe garantimin e zhvillimit normal të seancës, Kryetari i Këshillit ndihmohet nga punonjësi i ngarkuar për sigurinë, i cili kryen kryesisht detyrat e mëposhtme.

a) ndihmon në rregullimin e të pranishmëve në sallë;

b) ndihmon në shmangien e sjelljes së papërshtatshme të personave të pranishëm në sallë;

c) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e seancës dëgjimore.

#### Neni 36

##### Zhvillimi i seancës

1. Kryetari, pasi deklaron hapjen e seancës dëgjimore, verifikon kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e saj. Nëse ndonjë anëtar i Këshillit merr pjesë në mbledhje në distancë, Kryetari merr masa për realizimin e këtij komunikimi.

2. Pas hapjes së seancës dëgjimore, Kryetari i Këshillit, si drejtues i seancës, kryen këto veprime procedurale:

a) verifikon legjitimitimin procedural të palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative;

b) pyet palët nëse kanë ndonjë kërkesë procedurale, që lidhet me legjitimitimin apo zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor;

c) deklaron të hapur shqyrtimin e procedimit disiplinor;

ç) u bën të njohur palëve që përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore, sipas nenit 142, pika 4, e ligjit “Për statusin”;

d) u jep të drejtën e fjalës sipas radhës:

i. organit procedues, i cili paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masat disiplinore që duhet të merren;

ii. subjektit të proceduar ose përfaqësuesit të tij, për të paraqitur argumentet mbrojtëse. Në çdo rast magistrati i proceduar ka të drejtën e fjalës së fundit;

dh) komunikon vendimin e Këshillit:

i. për shtyrjen e seancës dëgjimore, në çdo rast, jo më shumë se një muaj, kur e konsideron të nevojshme marrjen e provave shtesë;

ii. për administrimin e provave, që plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, kanë lidhje me objektin e procedimit dhe kanë rëndësi në zgjidhjen e drejtë të çështjes;

iii. çdo vendim tjetër të marrë gjatë seancës dëgjimore;

iv. për mbylljen e fazës së shqyrtimit;

e) fton palët për pretendimet e fundit;

ë) shpall vendimin përfundimtar të procedimit.

3. Këshilli, gjatë seancës dëgjimore, me kërkesë ose kryesisht, merr çdo vendim sipas nenit 33, pika 2, gjerat “ç” dhe “d”, të kësaj rregulloreje.

4. Për zhvillimin dhe dokumentimin e seancës dëgjimore respektohen, me aq sa është e mundur, dhe rregullat e parashikuara për mbledhjet plenare.



Neni 37

### Masat për shmangien e vonesave

1. Këshilli zbaton rregullat procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, për atë sa këto rregulla gjejnë zbatim, për magjistratin ose përfaqësuesin e tij, në rastet e deklarimit në mungesë, si dhe të procedimit disiplinor në mungesë të tij.

2. Në rastin kur magjistrati ose përfaqësuesi i tij, dëshmitari, eksperti ose përkthyesi cenon dinjitetin e ILD-së ose të Këshillit, ose kryejnë ndonjë veprim, që në mënyrë të dukshme ka për qëllim të vonojë procedurën, Këshilli paralajmëron magjistratin dhe e udhëzon mbi pasojat e kësaj sjelljeje. Në rast se sjellja vazhdon, Këshilli vendos dënimin me gjobë deri në 100 000 lekë subjektin shkelës. Përsëritja e sjelljes përbën shkak për dhënien sërish të dënimit me gjobë dhe, nëse vlerësohet e përshtatshme, për fillimin e hetimit disiplinor ose penal.

3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim, brenda 24 orëve nga marrja dijeni e tij në Gjykatën Administrative të Apelit. Këshilli i njofton vendimin për dënimin me gjobë Dhomës Kombëtare të Avokatisë ose institucioneve përgjegjëse për ekspertët ose përkthyesit.

Neni 38

### Bashkimi i procedimeve disiplinore

Këshilli vendos bashkimin e procedimeve disiplinore, në rastet e mëposhtme:

a) procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit magjistrat të proceduar;

b) kur një gjyqtar ose një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje. Në këtë rast, Këshillat vendosin bashkimin e procedimeve, sipas rregullave të përbashkëta të miratuara paraprakisht prej tyre.

Neni 39

### Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor të magjistratit

1. Kur Këshilli çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë:

a) të urdhërojë ILD-në të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me ligjin “Për statusin”, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit njëmuajor;

b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim.

2. Në këto raste, ILD-ja vepron sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 136, të ligjit “Për statusin”:

a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit;

b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose të ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve.

Neni 40

### Pezullimi i procedimit disiplinor

1. Këshilli vendos pezullimin e procedimit disiplinor, kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil:

a) në të cilët, njëra nga palët është magjistrati i proceduar;

b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi.

2. Procedimi disiplinor pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent.

3. Ankuesi, magjistrati i proceduar, gjykata, prokuroria dhe subjektet proceduese njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Gjykata, prokuroria e interesuar ose institucione të tjera i dërgojnë Këshillit, pa vonesë, çdo vendim që merret gjatë hetimit dhe procesit përkatës.

4. Këshilli u referohet vetëm fakteve mbi të cilat bazohet vendimi i formës së prerë i gjykatës. Vendimi i formës së prerë i gjykatës në favor të magjistratit të proceduar, nuk pengon procedimin disiplinor të Këshillit për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të tij.

5. Vendimi për pezullimin e procedimit nuk ankimohet.



Neni 41

**Marrja e vendimit në një procedim disiplinor**

1. Pas shqyrtimit të fakteve dhe provave, Këshilli në mbledhje plenare:

a) rrëzon kërkesën për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore;

b) pranon kërkesën dhe vendos një ose më shumë masa disiplinore.

2. Vendimi jepet i arsyetuar me shkrim të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës. Nëse vendimi përfundimtar nuk shpallet menjëherë, Këshilli vendos për datën e marrjes së tij, datë e cila caktohet të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës dëgjimore<sup>1</sup>.

3. Relatori i çështjes garanton aksesin e të gjithë anëtarëve të Këshillit në njohjen e akteve të administruara në dosje, gjatë shqyrtimit të çështjes dhe para marrjes së vendimit përfundimtar.

Neni 42

**Përgatitja e vendimit**

1. Arsyetimi dhe zbardhja e plotë e vendimit bëhet brenda dy javëve, nga data e shpalljes së tij. Vendimi arsyetohet nga Relatori, duke mbajtur parasysh deklaratimet për arsytet e votimit në marrjen e vendimit. Relatori u përcjell anëtarëve të Këshillit projektvendimin e dhënë.

2. Secili prej anëtarëve, mund të japë komentet dhe propozimet e tij me shkrim, të cilat përfshihen në projektvendim. Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe miratojnë me anë të nënshkrimit versionin përfundimtar të vendimit.

3. Nëse pas votimit dhe shpalljes së vendimit, Relatori është në pakicë, Kryetari i Këshillit, mund të caktojë një anëtar tjetër nga shumica për të arsyetuar vendimin përfundimtar.

Neni 43

**Publikimi i vendimeve disiplinore**

1. Këshilli publikon, brenda 2 javëve, çdo vendim të formës së prerë për shkarkimin e magistratëve në faqen zyrtare.

<sup>1</sup> Neni 146, pika 3, e ligjit “Për statusin” – “Këshilli nuk është i detyruar t’i qëndrojë masës disiplinore të propozuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim të paktën brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.”

2. Këshilli publikon ekstrakte të çdo vendimi përfundimtar për çështje disiplinore, duke përcaktuar rrethanat e fakteve, provat e administruara, vlerën provuese të tyre, si dhe llojin e shkeljes disiplinore të kryer sipas këtyre fakteve. Botimi i ekstrakteve duhet të mbrojtë të dhënat personale dhe të garantojë mbrojtjen e konfidencialitetit. Në çdo rast, në ekstrakt nuk botohet asnjë informacion që mund të tregojë identitetin e magistratit.

Neni 44

**Shqyrtimi i marrëveshjes së përbashkët të pranimit**

Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e shqyrtimit të marrëveshjes së përbashkët të pranimit, sipas nenit 135, të ligjit “Për statusin”, për aq sa gjen zbatim.

KREU IV

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 45

**Shfuqizime**

Rregullorja “Për procedimin disiplinor të gjyqtarëve”, të miratuar me vendimin nr. 137, datë 21.2.2003, ndryshuar me vendimin nr. 282/9, datë 16.12.2011, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 46

**Akte të tjera të zbatueshme**

Në organizimin dhe funksionimin e Këshillit, Komisionit dhe personelit administrativ, sipas kësaj rregulloreje, gjejnë zbatim rregullore të tjera të Këshillit, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

Neni 47

**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.



**NJOFTIM**  
**Nr. 10389, datë 14.9.2020**

**MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË  
MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2019, për projektin “Për një transport publik udhëtarësh miqësor me mjedisin në metropolin e Tiranës (DKTI)”, ka hyrë në fuqi më 2 shtator 2020.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM  
I MINISTRISË  
PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME  
Armand Skapi**









*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 364 lekë